

Muhamet Pirraku

## GAZETA „SHKUPI” (DISA KATEGORI TË MENDIMIT POLITIK E SHOQËROR TË SAJ)

### Hyrje

Gazeta „SHKUPI” është organ i parë në gjuhën shqipe në viset e Vilajetit të Kosovës. Vendimi për nxjerrjen e saj është marrë në *Kongresin II të Manastirit*,<sup>1</sup> por për shkak se pëlsiti Kryengritja e Kosovës e vitit 1910, vendimi u sendërtua afro dy vjet e gjysmë më vonë. Doli, sipas kalendarit julian, ditën e hënë, më 29 gusht 1911, si gazetë e përjavshme me devizë — „Prun’ interest’ e Kombit”, e drejtuar nga „një tufë shqiptarë” në krye me publicistin e njohur në shqipet, turqishte dhe serbokroatishte, *Jashar S. EREBARËN*.<sup>2</sup> Numri i fundit doli më 19 shtator 1912, vetëm pesë ditë para se të fillonte *Lufta Ballkanike*.

Doli në katër faqe me format 26, 5 x 36 cm.<sup>3</sup> Dy faqet e para dilnin në gjuhën shqipe me alfabetin e „*Bashkimit*”, përkatësisht të *Manastirit*, kurse dy të fundit në gjuhën turke me alfabetin arabo-turk. Në të shumtën e rasteve tekstet nuk janë përkthim ose adaptim prej njëres në gjuhën tjetër. Tekstet në gjuhën shqipe kanë përmbajtje më shumë revolucionare në vijën e ideologjisë demokratike shqiptare.<sup>4</sup>

Botohej me një thyerje teknike të bukur, me tituj të plotë dhe të kuptueshëm, me kryeartikuj të stilizuar, me mendime, sarkazma dhe proverba të zgjedhur me shije dhe adekuat të përdorur, të nënvizuar në kursiv dhe petit. Gabimet teknike dhe gjuhësore, të cilat nuk janë të pakëta,

<sup>1</sup> Është mbajtur më 20-22 mars (2-4 prill) 1910 nën kryesinë e *Bedri be Pejani*, mësues në shkollën edukative *Meçtebi Edeb* në Shkup. Në këtë kongres kulturor-politik u vendos definitivisht alfabeti kombëtar. Më gjerë shih *M. Pirraku, Kongresi i dytë i Manastirit, Fjala 9/67*.

<sup>2</sup> *Erebarë* u rritë, në Dibër. Heret kaloi në Rumani dhe pati fatin të bëhet nxënës i shkollës normale të *Naços*. Nga fundi i viteve XIX u kushtua çështjes kombëtare shqiptare. U muar me publicistikë. Pas tjerash nxori gazetën „*Albania*” në Beograd (1901-1905) dhe „*Shkupi*” në Shkup (1911-1912).

<sup>3</sup> Në vitin 1911 doli prej No-1 deri No-24, kurse gjatë vitit 1912 doli No-15 deri No-33. Pranë Arkivit të Kosovës gjenden numrat: 1,2,3,5,6,7,8,9,10,11,12,13,14,16,17,18,19,20,23,24,25,27,28,29,30,32,33.

<sup>4</sup> Për punimin tonë e kemi shfrytëzuar vetëm tekstin në gjuhën shqipe, por e kemi konsultuar edhe atë në turqishtet.

nuk e ulin vlerën, rëndësinë e porosive të ideve të pasqyruara në faqet e gazetës.<sup>5</sup>

Problematika e trajtuar në faqet e saj është e larmishme dhe paraqet një thesar të çmueshëm të lëndës burimore për kërkime historike dhe gjuhësore. Edhe pse nuk kishte rubrika standarde, zakonisht, në faqen e parë botonte informata mbi rrethanat politike në Ballkan, Evropë dhe në botë të ndërthurura me problematikë nga Atdheu dhe Perandoria. Në faqen e dytë shkruante për rrethanat politike kulturore dhe ekonomike në viset e banuara me shqiptarë, me një përqëndrim në Vilajetin e Kosovës.

Gazeta kishte bashkëpunëtorë nga të gjitha viset e banuara me shqiptarë. Kjo del nga përmbajtja e artikujve, nga stili i pendave dhe nga gjuha. Megjithatë, artikujt e botuar në gazetë i shtroheshin redakturës serioze të kryeredaktorit *Erebara*. Kjo ka kontribuar që mendimi politik e shoqëror në kuptimin horizontal dhe vertikal, përkatësisht në gjërësi dhe thellësi të trajtesave në faqet e saj të zhvillohej dhe kultivohej i përqëndruar në ide, i pasur i rrjedhshëm dhe i kuptueshëm e me ndikim të madh në lexuesit.<sup>6</sup>

Varësisht nga problematika me të cilën është ballafaquar SHKUPI, kategoritë e mendimit politik e shoqëror, të kultivuara në faqet e saj, ka mundësi të sistematizohen në: fryma politike e shoqërore e linjës programatike, idetë arsimore, idetë mbi kombësinë, idetë demokratike, fryma politike e shoqërore e trajtesave gjuhësore, kultivimi i historisë, lufta kundër propagandës së huaj në dëm të shqiptarëve, qëndrimi politik ndaj qeverisë turke dhe partive politike në Turqi, pastaj ndaj hakmarrjes kryengritjeve shqiptare; vizioni dhe qëndrimi ndaj politikës ekspansioniste të borgjezive të fqinjëve në tokat e Perandorisë, vizioni ndaj politikës kolonialiste të fuqive të mëdha në tokat e po kësaj perandorie, konceptonet mbi përfaqësimin e popullit, idetë mbi autonominë dhe pavarësinë kombëtare dhe fryma e mendimit politik e shoqëror e poezisë së botuar në SHKUPI.

Sistematizimin e tillë të ideve në këtë gazetë e kemi bërë të shtyrë nga kërkesat metodologjike që kërkon qëllimi i këtij studimi.

## 1. Fryma politike e shoqërore e linjës programatike

Mendimi politik e shoqëror në gazetën Shkupi në vete mban vulën e porosisë, ngritë çështjen, nxit aksione në të mirën e lëvizjes kombëtare shqiptare. Linja programatike e saj ishte përqëndruar në luftën për hapjen e shkollës shqipe dhe emancipimin kombëtar, për luftën e pakompromis deri në fitoren e pavarësisë që dilte nga programi politik i Rilindjes Kombëtare. U vinte në spikamë kundërshtarëve të lëvizjes se e tërë lëvizja shqiptare nuk

<sup>5</sup> Në gazetën SHKUPI artikujt botoheshin pa emër të autorit. Kështu është vepruar për ruajtjen e autorëve nga konsekuencat e cenzurës. *Në n'gazetën ton askujt s ja qesim emnin n'noj shkrim qe na e dergon,, per veç se n'noj kange''* shih nr. 20/ 1 mars 1912 f. 2.

<sup>6</sup> Nr. 19/20 shkurt 1912/2.

ka tjetër qëllim përpos njësimin dhe unitetit kombëtar në frymën e shek. XX — „Dituni-mësim në gjuhën e vet, se kjo asht ma e shkurta rrugë për — LIRI”.<sup>7</sup> I thërriste bashkëkohësit që të mos humbasin kohë, sepse çdo minut për ta „asht shumë e vyer” të ngrehin shoqëri kombëtare për çdo qytet dhe katund, të gjejnë mësues dhe të hapin shkolla me alfabetin shqip. U vinte në dije se „një kombë qi z’di gjuhën e vet me shkru e kendu ay kombë jetës s’ka në shekullin XX”.<sup>8</sup> Duke vënë në pah rreziqet për kombin shqiptar, të përgatitur nga borgjezia e popujve fqinj, i thërriste atdhetarët t’i vijnë në ndihmë „kësaj gazete në Gegni”, e cila do të dëshmojë se „ne shqiptarët e Kosovës jemi gjallë e rojmë si millet dhe punojmë për millet”. U sugjeronte të zgjohen, të hapnin sht, „mos flini s’e zeza dit do t’u hajë dhe sido neve në Kosovë”.<sup>9</sup>

Ajo i thërriste bashkëkohësit kosovarë të kapën për punë të shenjtë, për shkolla dhe mësim në gjuhën shqipe „pse ju maa tepër se t’gjith tjerët Shqiptarë jeni maa n’rrezik me hupun e m’u zhdukun prej faqes s’dheut”.<sup>10</sup> U vënë në dije se po të t’fillën në ato rrugë, kombi do të rritet dhe do të forcohet e atdheu do të madhërohet. Për të realizuar këtë ide programatike trumbetoi për hapjen e një klubi për shqiptarë në Shkup, i cili do t’i tubonte të rinjtë dhe nxënësit në shkollat shtetërore.<sup>11</sup> Klubi do të merrej me botimin dhe përhapjen e librave shqipe. Do të punojë dhe për hapjen e një shkolle të profesioneve e të mjeshtrive ku do të mësonin „djemt e Shqiptarëve”. Kjo punë do të largonte errësirën „e paadijes qi na kaa mlue”. Realizimin e kësaj ideje duhej ta ndihmonin shqiptarët e pasur në Shkup, „e qi donë t’mirën e kombit e vendit t’onë”. Klubi do të shërbente edhe për tubimin e atdhetarëve ku do të flisnin për arsim dhe emancipim politik kombëtar. Gazeta ishte zëdhënëse e hapjes së shkollës shqipe me alfabetin latin: „Simboli i Shqiptarit asht Ditunia shqip e harfet tona!” dhe aludonte — „le t’a msojë shqiptari gjuhën e vet me harfet e veta”.<sup>12</sup>

Në linjën programatike të organit bënte pjesë edhe përpjekja për lidhjen e shtresave të pasura shoqërore me çështjen kombëtare. Konstatonte se të pasurit kanë për detyrë ta ndihmojnë kombin edhe me para, ashtu si veproi Naimi, Samiu e të tjerë bëmires për hapjen dhe mbrojtjen e shkollës shqipe „t’cilat do mushen me nxenjës shqiptar?”<sup>13</sup> dhe për nxjerrjen e gazetës *Shkupi* e cila ka për program „lulzimin e kombit t’onë”. Duke vënë në spikamë shërbimet e gazetës për kombin dhe atdheun zotohej se edhe mëtutje do të shkonte „asaj rrugë e ati idealit bukur qi ka çdo atdhetar”.<sup>14</sup> Në shembëll të filantropit tiranas Jusuf Elezit, i cili me para të veta kishte hapur një shkollë shqipe dhe kishte emëruar për mësues Hafis IBRAHIMIN, i

<sup>7</sup> Nr. 1/29 gusht 1911 f. 1. Kryeart. „E pamë me udhë t’i themi këto pakë fjalë si parathanie”

<sup>8</sup> Aty, Art. „I verbë është ay qi z’di me kënu e shkru si ay qi ka ande po s’ka të hajë”

<sup>9</sup> Nr. 3/12 shtator 1911, f. 1. Art. „Lutje ka atdhetarët shqiptar” e nënshkruar „Nga Zyra (Idarea) e „Shkupit”

<sup>10</sup> Nr. 7/15 tetor 1911, f. 2. Art. „Kosova”

<sup>11</sup> Nr. 8/22 tetor 1911, f. 1. Art. „Nji nevojë e madhe për Shkup”

<sup>12</sup> Nr. 20/1 mars 1912, f. 2.

<sup>13</sup> Aty.

<sup>14</sup> Nr. 27/ 15 maj 1912, f. 2.

thërriste bashkëkohësit të shkojnë rrugës që ai shënoi — *të hapin shkolla shqipe për të mirë të kombit*.<sup>15</sup> U drejtohej atdhetarëve dhe opinionit botëror demokratik „*e zemër bardhë*” që ta ndihmojnë popullin shqiptarë për realizimin e kërkesave të tij vitale, o bile të mos e pengojnë në realizimin e atyre kërkesave. Gazeta para botës së qytetëruar shpalli programën politike, për kohën e vet shumë revolucionar: „*O, ja një Shqipni e një millet Arnaud ... se ndryshe i kthejm pushken gjith kujt kush ka me na shkel!*”<sup>16</sup>

## 2. Idetë arsimore

Arsimi i popullit në gjuhën shqipe ishte problemi më i trajtuar në organ. Konceptcionet mbi arsimin e përgjithshëm kombëtar i paraqet duke filluar nga numri i parë.<sup>17</sup> Gazeta solli lajme më pak nga dëshira të përhapte sa më shumë ide të reja „*që të mësojmë gjuhën tonë të shkojmë përpara se koha s'pret!*”<sup>18</sup> Me kujdes të madh e përcoll lëvizjen kulturore në viset e banuara me shqiptarë, e posaçërisht në Kosovë. Shkruante për atdhetarët që ndihmuan shkollën shqipe duke u njohur atyre meritat para kombit. Veçmas vuri në spikamë përpjekjen e Bajram CURRIT për hapjen e shkollës shqipe në Gjakovë e rrethinë: „*Ja ditë kombi për mirë dhe emni kur mos iu haroft sa të rojë Shqipënia!*”<sup>19</sup> Për SHKUPIN elementi kryesor i kombit është gjuha ndaj i thërriste bashkëkohësit të ndjekin shembëllën e dibranëve të anës së REKES, të besimit ortodoks, të cilët i shkruan patrikut në Stamboll se më nuk do të pranonin priftër, mësues e as gjuhën e huaj — „*po do mësojnë si në kishë, ashtu edhe në shkollë gjuhën 'e vet shqipten!*”. Këta dibranë, për hir të gjuhës shqipe, vendosën të lënë edhe ritin e besimit ortodoks dhe „*do hyn nen hije të Papes!*”<sup>20</sup>

Duke ndjekë shembullin e organeve të tjera të Rilindjes ajo mbajti lidhje të ngushtë me albanologë dhe me miqtë e popullit shqiptarë, si me H. GUYS, mikun e shkencëtarin albanolog LEGRAND e të tjerë. Guys, pas vdekjes së Legrandit, botoi pjesën e parë të veprës së tij BIBLIOGRAFIA SHQIPE dhe planifikoi botimin e pjesës së dytë. Shpresonte se punën e tij do ta përkrahnin ata që „*dëshërojnë mbrothësinë e kombit shqiptar!*”<sup>21</sup>

Merita e këtij organi në lëmin e arsimit kombëtar qëndron edhe në faktin se, ndonëse e përcjell nga një cenzurë shumë e madhe, asnjëherë nuk besoi në premtimet dhe aktet zyrtare formale të qeverisë mbi çështjen kombëtare shqiptare dhe gjithmonë, para se të bëhej realitet i sinjalizoi bashkëkohësit për planet dinake të qeverisë për të varrosur kombin shqiptar. *Shkupi* është ndër organet e para kombëtare që dyshoi në vendimin e qeverisë për rihapjen e shkollave shqipe dhe njohjen zyrtare të Alfabetit të

<sup>15</sup> Nr. 28/2 qershor 1912, f. 2. Art. „*Një filantrop shqiptar!*”

<sup>16</sup> Nr. 33/19 shtator 1912, f. 1. Art. „*Lutje!*”

<sup>17</sup> Nr. 11/ 16 nëntor 1911, f. 2.

<sup>18</sup> Nr. 2/5 shtator 1911, f. 2.

<sup>19</sup> Nr. 5/26 shtator 1911, 2.

<sup>20</sup> Nr. 7/15 tetor 1911, f. 2 Art. „*Gjuha në Dibër!*”

<sup>21</sup> Nr. 9/29 tetor 1911, f. 2.

Manastirit. Urdhërin e qeverisë për kthimin e shkollave fillore turke në Shqipëri në shkollat shqipe shtetërore e komunikoi Kryetari i Klubit Qendror të shqiptarëve në Stamboll Abdyl be YPI, me letërqarkoren e 28 nëntorit 1911. Shkupi e botoi këtë letërqarkore dhe e komentoi vetëm me një fjali të vetme: „*Sh. She., Shenjt Toma: Pa pam me sy gjo s'besoj!*”<sup>22</sup>

Nuk vonoi dhe doli e vërteta. Filloi ndjekja dhe burgosja e partizanëve të kulturës kombëtare shqiptare. Shkupi më me vendosmëri se çdo organ tjetër kombëtar në atdhe, e ngriti zërin kundër vendimit të qeverisë që shqiptarët të përdornin dy alfabetet, atë arabo-turke dhe atë latin, sipas dëshirës së tyre. Këtë dinakëri të qeverisë gazeta e quajti „*qëllim makjavelik*”. Vinte në pah se në të gjitha vendet me shqiptarë gjenden edhe njerës të trullosur nga ndjenat fanatike muslimane dhe „*të verbuem prej pa-ditunisë*” — do të pëlqejnë alfabetin e armikut shekullor duke lënë alfabetin e vet kombëtar. U ngrit kundër inspektorëve të dërguar nga qeveria në Shqipëri, për të propaganduar kundër alfabetit latin të shkollës shqipe. Ky organ luftën e vet për shkollën shqipe me mjeshtri e lidhi me luftën e deputetëve dhe patriotëve për hapjen dhe mbrojtjen e kësaj shkolle. Në faqet e veta zuri n'goje meritat e senatorit Sylejman KOLONJES, deputetëve Nexhib DRAGA, Hasan PRISHTINA, Gani FRASHËRI, Myfid GJINOKASTRA e të tjerë. Këta në Stamboll themeluan një KLUB me detyrë që të mblidhte kontribute nga atdhetarët „*qi dishrojnë lulzimin'e gjuhës e t'mësimit!*” Ky klub posaçërisht u kujdes për mbajtjen e NORMALES NË ELBASAN.<sup>23</sup> Rihapja e kësaj shkolle për gazetën Shkupi ishte festë kombëtare. Në faqet e veta i dha vend të dukshëm letërqarkores së KOMITETIT SUNDIMTAR të Normales, të datës 13 mars 1912, ku theksohej se kjo shkollë „*nde zemrat e Shqipëtarëve ju përfytyron qëndron nga e cila do t'epet drita e qytetnimit e e dijeve nëpër Shqipëri*”.<sup>24</sup> Redaksia në luftën për hapjen e shkollave shqipe i kontribuoi edhe përhapjes së librit shqip. Konstatonin se librat shqip „*ku do i dajm t'varfunve shqiptar pa të holla*”.<sup>25</sup>

### 3. Idetë mbi kombësinë

Kultivimi i idesë mbi kombësinë në këtë organ ishte tema më programatike. Ideja e kombësisë e përshkonte tërë gazetën si fill i kuq. Ajo u ngrit kundër traditave fetare dhe fisnore që shkonin në dëm të unitetit kombëtar. Me sukses dhe guxim revolucionar e luftoi fanatizmin fetar. Këtu qëndronte edhe „*Nyja e Gardijeut*” në çështjen kombëtare. Aso kohe jetonin në Ballkan rreth *dy milionë* shqiptarë të ndarë në tri besime. Njëqind e pesëdhjet mijë i takonin besimit katolik, nja treqind mijë ortodoks, kurse të tjerët besimit musliman, por edhe këta të ndarë në mbi dhjetë sekte.

<sup>22</sup> Nr. 12/8 dhetur 1911, f. 1.

<sup>23</sup> Nr. 15/8 janar 1912, f. 1.

<sup>24</sup> Nr. 23/1 prill 1912, f. 2.

<sup>25</sup> Nr. 27/15 maj 1912, f. 2.

Fanatizmi fetar hapi me kohë jaz midis shqiptarëve me besime të ndryshme. Kësaj i ndihmonte edhe propaganda e huaj armiqësore kundër së cilës me sukses luftoi Shkupi, duke i thirrur shqiptarët në bashkim: „*Mos t'habitemi, mos t'rrehmi, mos t'dahmi për punë t'Fesë: të ton Shqyptar jemi, një gjak kemi, një gjuh flasim. Mos t'knaçen anmiqt ton, tui na pa keq ner vedi!*”<sup>26</sup> Me vizion të pashoq e luftoi edhe ndarjen krahinore në Toskëri dhe Gegëri. „*Po, shka do me thon Tosk e Geg? Po a s'jemi të tan Shqyptar? s'jemi të tan prej nii babet? S'kemi të ton një gjak? S'flasim të ton një gjuh!*” dhe kredo për bashkimin kombëtar e mori mendimin e shkrimtarit të Romës së vjetër, Salastius: „*Concordis minima erescunt, discerdis maxima dila bundur*” — (Me bashkim gjërat e vogla rriten, e me të ndarë, gjërat e mëdha humbasin).<sup>27</sup>

Organi Shkupi e lartësoi burrërinë, trimërinë, nderin, urtinë, mendjehollësinë, por edhe kritikoi anët e dobëta të këtij populli e në radhë të parë pse ishte ftohur në mësimin e gjuhës shqipe. Konstatonte se shkak u që shqiptarët, si popull i vjetër i Ballkanit, është humbur e asimiluar kaq shumë, është mosmësuarja e gjuhës së vet shqipe — „*Qe praa arsyeja pse kemi hupun e jemi pakue përherë*”.<sup>28</sup>

Duke luftuar në dobi të kultivimit të ideve kombëtare me sukses u ngrit edhe kundër klubeve kulturore xhonturke, të cilat vepronin në dëm të çështjes kombëtare shqiptare. Një kritikë të tillë i bëri edhe klubi *Shuban-i Vatan* në Shkup i cili i bishtnonte aksionit për përhapjen e mësimin shqip,<sup>29</sup> Gazeta aludonte për krijimin e njeriut të pastër kombëtar të tipit të rilindësve, të cilët, duke punuar për atdhe dhe kombësi, u bënë theror të Kombit.<sup>30</sup>

#### 4. Idetë demokratike dhe socialiste

Edhe idetë demokratike, madje edhe socialiste, e përshkojnë si fill i kuq. Zaten, ky ishte organ politik kombëtar i lëvizjes shqiptare i lindur dhe i rritur mbi baza të mendimit dhe luftës revolucionare demokratike. Si organ kombëtar luftoi pa e ulur zërin kundër politikës shoviniste të borgjezive të shteteve fqinje dhe politikës koloniale të fuqive të mëdha ndaj vendeve të banuara me shqiptarë dhe maqedonë. U përpoq për afrimin e popujve të Ballkanit mbi baza demokratike revolucionare: „*Nuk dojmë asgjë të huajin, por edhe nuk dhëmë asgjë nga e jona!*”<sup>31</sup> Duke e kritikuar idenë për Federatën Ballkanike të përhapur nga fuqitë imperialiste, Rusia dhe Anglia (autor i së cilës ishte Qeveria e Serbisë) paraqiti programin revolucionar

<sup>26</sup> Nr. 5/26 shtator 1911, f. 2.

<sup>27</sup> Nr. 6/8 tetor 1911, f. 1.

<sup>28</sup> Nr. 7/15 tetor 1911, f. 2.

<sup>29</sup> Nr. 16/17 janar 1912, f. 2. „*Shqypnija dhe Turqia*”

<sup>30</sup> Nr. 17/27 janar 1912, f. 2. Art. „*Ke boimërisit Atdhetar!*”

<sup>31</sup> Nr. 10/5 nëntor 1911, f. 1.

demokratik të lëvizjes shqiptare në FEDERATË: „*Shqipëtarët prej t' tri fejave s'kan dishir tjetër veç: Shkolla me guhen shqipe t' pagu nga mearifi, kjo let bonet dhe për tjera kombe*”. I thërriste shqiptarët, bullgarët, maqedonët, grekët e të tjerë se „*tash a bash koha të rim urtë e të rojmë si vllaznit [...] e t' mos bonemi aleati i huaj tue gran bukën e vet. Hapni syt e mos bohemi pishman të voni!*” sepse si thotë fjala e urtë turke: *Son pişmanlik fajde olmas! — pendimi i vonë nuk sjell dobi*. Vinte në spikam se Anglia dhe Rusia e dëshirojnë bashkimin e popujve të Ballkanit për qëllime të veta e jo për të mirën e ballkanasve.<sup>32</sup>

Në fillim të shekullit XX në Londër vepronte një komitet revolucionar i quajtur *Ballkan* i cili kishte tubuar rreth vetes social-demokratë nga të gjitha nacionalitetet e Ballkanit, e që ishin vënë në lëvizje për çlirimin nacional dhe klasor të popujve të vet.<sup>33</sup> Anëtar i këtij komiteti ishte edhe vëllai i Nexhib DRAGËS Ferat DRAGA.<sup>32</sup> Komiteti quhej VËLLAZËRIT E KUQ i cili kultivoi ide mbi lëvizjen socialiste punëtore.<sup>35</sup> SHKUPI i dha publicitet apelit të këtij komiteti, ku kërkohej: „*t' ipet Shqipënis e Maqedonis autonomi (mustekil nji idare)*”.<sup>36</sup>

Sipas Shkupit *Vëllazërit e kuq* ishte organizatë revolucionare ilegale e popujve të Ballkanit. Ajo vinte në spikamë se ishte „*një shoqëri*” revolucionare e punëtorëve, e përhapur në tërë botën për luftë kundër oligarkisë dhe kapitalistëve. Konstatonte se „*gjeja e parja asht permledhun n' pak duer [...], e këta me fabrika t' mdhaja qi kanë çilë gjithkund i kan marrë bukën prej gojet vogjlies?*”. Konstatonte se vuajtjet e shumta të shkaktuara nga eksploatuesit i kanë shtyrë punëtorët të bashkohen me „*nji shoqni paa shikjue as fee as komssi, por si njers me u mundue bashkarisht për t' mirë t' vetvedit, me fitue t' drejtat e veta e t' gjith bashkë mandej me ju kundersh tue kapitalistavet qi kqyrin me pui gjakun puntories s' shkretë*”. *Vëllazërit e kuq*, shkruante Shkupi, janë kundër rekrutimit të rinisë në ushtri duke vënë në pah se luftërat që zhvillojnë qeveritë borgjeze shkaktojnë rrënimin e vegjëlisë për llogari të kapitalistëve. Janë edhe kundër „*fees e dinit*”, sepse ato përçajnë „*njerst qi vyjnë me kanë vllazen me shoqi shoqinë e e laan n' terr vogjlien*”. Gazeta theksonte se „*kto shoqnina puntorësh thirren Socialiste por edhe t' kuq, pse boja e kuqe asht shenji i tyre*”.<sup>37</sup> Duke botuar letrën e hapët të *Vëllaznive të Kuq* drejtuar qeverisë së Stambollit dhe qeverive të shteteve ballkanike, të cilat ndiqnin një politikë grabitçare „*për rrënim e për t' zezë t' vendeve t' ona*”, konstatonte: *Vëllazërit e kuq kërkojnë të ndërrohet „saa maa parë [...] kjo politikë e mrapshtë” dhe të sigurohet e drejta e kombësisë dhe liria për të gjithë popujt në Perandori. Të sigurohet paqja në Ballkan dhe*

<sup>32</sup> Nr. 9/29 tetor 1911, f. 1. Art. „*Federata Ballkanike*”

<sup>33</sup> Nr. 15/8 janar 1912, f. 2.

<sup>34</sup> Nr. 10/5 nëntor 1911, f. 1. Ferat Draga ishte politikan i dalluar midis dy luftërave botërore. I përkiste partisë politike demokratike popullore shqiptare „*Xhemi*” dhe *Bashkinut të Muslimanëve* si ideolog kombëtar shqiptar borgjez. Nuk pranoi bashkëpunim me LNÇ dhe vdiq në arrati menjëherë pas çlirimit.

<sup>35</sup> Nr. 15/8 janar 1912 f. 2.

<sup>36</sup> Nr. 24/11 prill 1912, f. 2.

<sup>37</sup> Nr. 18/8 shkurt 1912, f. 1. Kryeart. „*Vllaznit e Kuq*”

„me shtie vllaznien ndërmjet popujve t'Ballkanit". Zotohen se „n'emen t'lrises kemi me que bajrakun e kryengritjs t'Ballkanasvet" dhe thërrisin: „Atdhetarë e Kryengritas, grumbulloniu rreth bajrakut t'onë!" Përfundonin me: „Rroftë t'besatuemit e Ballkanvet! Rroftë kryengritja e ballkanvet!"<sup>38</sup> Në vazhdim, si miratim të plotë të kërkesave të Vëllaznive të Kuq, me guxim të madh Shkupi u ngrit kundër qeveritarëve dhe eksploatuesve feudalo-borgjezë xhonturq dhe konstatonte se: „Sot Turqia asht çiflik i disave njers t'cillit pa shpirt po e repin si ç'don ata". Gazeta u kërcënohej xhemijetlinjve, përfaqësues të borgjezisë në Perandori, se „koha do kthehet, e mos kujtoni ju se do e repni ket millet sikundra e kenë pas rejepun deri sot".<sup>39</sup>

Kështu, nga përmbajtja e artikujve që ngërthejnë ide demokratike dhe socialiste shihet se Shkupi lirinë e priste nga revolucioni demokratik e vëllazëror i popujve të Ballkanit, të cilit duhej t'i printe një përgatitje e tërësishme e popullit — arsimi kombëtar.

## 5. Kultivimi i historisë

Si organ i masave të gjëra popullore kjo gazetë i kushtoi kujdes të madh kultivimit të historisë nacionale dhe të përgjithshme. Idetë lidhur me problemin e shtruar i paraqiti në të gjithë numrat e vet lidhur me problematikën kombëtare dhe ndërkombëtare që trajtoi. Në numrin e parë, konceptonin mbi shpjegimin e ngjarjeve historike, e ka lidhur me të kaluarën e popullit që kishte jetuar dhe jetonte në brigjet e lumit Vardar dhe të emrit të këtij lumi. Sipas saj emri *Shkupi* është përdorur edhe në kohën romake, gjë që e kishte zënë ngoje një historian venecian „tani 400 vjet para", në rrugë Shkup — Jeni Pazar. Ai midis të tjerash, kishte shënuar se „në Shkup gjuha e parë dhe collen e flasin gjithë Shkupi e Kazaja, asht gjuha shqipe. Në Jeni Pazar [...] vendësit flasin dy gjuhë: Shqip e Serbisht".<sup>40</sup> Shkupi, duke propaganduar veprën historike të Kristo Dakos i thërriste bashkëkohësit të mësojnë se kush kanë qenë, kush janë dhe ku do të shkojnë, gjë që mund të arrijnë vetëm duke lexuar historinë e Dakos.<sup>41</sup>

Hulumtimin dhe mësimin e historisë nacionale *Shkupi* e preferonte në konstelacion me hulumtimin dhe mësimin e historisë, bashkëkohëse dhe të shkuar, të përgjithshme. Kështu, të ndërthurur, e shpjegoi rolin dhe rëndësinë e Lekës së Madh (Aleksandrit të Maqedonisë), mbi zgjërimit dhe shtetit të tij dhe pasojat e pushtimit dhe vdekjes së tij për popullin anas në Maqedoni. Ky organ konstatonte se *Leka* ishte burrë shteti shqiptar, i mençur, i urtë, i mirë, trim dhe i cili „vdesë nga dora e një thike të një tradhtorit ligë në Babilonë", e jo nga malarja si na mëson historia.<sup>42</sup> Shkupi i kushtoi

<sup>38</sup> Aty.

<sup>39</sup> Aty. Art. „Turqia asht jalli kurjuk a çiflik" — Eshtë Turqia bisht i majshem (yndyrëshem) a çifllëk.

<sup>40</sup> Nr. 1/29 gusht 1911, f. 2. Kryeart. „Nota diplomacies kohes e vjetër dhe diplomacia e kohës sotçme".

<sup>41</sup> Nr. 19/20 shkurt 1912 f. 2. Art. „A doni t'dini se ç'asht Shqypenia e komi Shqipetar?"

<sup>42</sup> Nr. 2/5 shtator 1911. f. 1.

rëndësi edhe hulumtimit të toponomastikës historike dhe gjeografike nga aspekti gjuhësor dhe historik-politik.<sup>43</sup> Duke bërë fjalë mbi migrimet dhe përmbytjet që perjetuan popujt dhe ato që sollën asimilimin e popullit shqiptar në shumë treva ku u krijuan si popull, u ndal mbi etimologjinë dhe fatin e emrit Maqedoni, mbi banorët e saj në kohën para erës sonë dhe në mesjetë dhe pë rrethanat politike dhe administrative në Maqedoni në Fillim të shek. XX. Sipas *Shkupit* emri M a q e d o n i vjen nga fjala shqipe m a q j a dhe d h o n i d h a n i e, plot, bollëk. Nga kjo *Maqj'e e madhe* — Maqedhoni. Konstatoi se në këtë trevë „nder kohë t'vjetra kan pasë ndejur [...] popuj qi me nee Shqyptarët kanë pasë kenë një komit e nji guhet” dhe se pas vdekjes së Lekës së Madh Maqedonia bie nën sundimin e romakëve, gjersa me ardhjen e sllavëve nën sundimin e tyre. Më vonë erdhën edhe turqit dhe kështu kjo trevë u bë vatër për shumë popuj. Popullsia vendëse iu shtrua asimilimit të huaj. Popullsia e vjetër, maqedonët e Lekës, që ishin pellazgë si dhe shqiptarët, u ruajtën si shqiptarë vetëm në viset e Kumanovës, Tetovës, Shkupit, Dibrës, Ohrit, dhe të Manastirit, por edhe këtu kohëve të vona populli shqiptar i qe shtruar shtypjes dhe propagandës së të huajve që e shpënin drejt asimilimit të pashmangshëm. Shqiptarët nuk gëzonin kurrfarë të drejtash kombëtare e bile, as atë ta quanin veten me emrin e vet — S h q i p t a r. Madje në fillim të shek. XX. opinionin evropian dhe botëror, i ndikuar nga propaganda e Greqisë, Serbisë dhe Bullgarisë e të tjerëve, nuk dinte se në Maqedoni do të ketë edhe ndonjë popull tjetër pos „grekëve”, „serbëve” dhe „bullgarëve”.

Për një fat të tillë të popullit shqiptar dhe për dezorientime të tilla nuk fajësohej Evropa, por Turqia: „Krejt fajin e kishte Stambolla, qi nee nuk na linte m'u thirrë Shqyptarë; e i mjeri aj qi guxoke me kendue libra e gazeta shqype, pse me nji herë u fërflloke nder burgje a se tretke kah Anadollit”. Bashkatdhetarëve u bëhej me dije se po nuk punuan për zgjimin kombëtar, se po të flinin edhe mëtutje „kan me hupë, si kanë hupë vllaznit t'onë t'Maqedonisë”.<sup>44</sup>

*Shkupi* veçmas i kushtoi kujdes kultivimit të historisë së popullit në Kosovë, duke e trajtuar si histori të krahinës, si territor gjeografik të Vilajetit të Kosovës, dhe si njësi administrative territoriale që përfshinte edhe viset e Dukagjinit, Preshevës, Shkupit, Tetovës e të tjera. Kujdes të posaçëm i kushtoi etnonimisë dhe demografisë. Sipas kësaj gazete viset e Vilajetit të Kosovës dhe të Kosovës si regjion, në kohën parahistorike dhe historike, kanë qenë të banuara me paraardhësit e popullit shqiptar. Vihet në spikamë se në këto treva ndër kohë kanë depërtuar, si pushtues, „gjithë farë komesh t'ndryshme” të cilat asimiluan një pjesë të madhe të popullatës autoktone. Megjithatë, elementi autokton edhe mëtutje u ruajt në numër, më shumë, dhe gjuha shqipe si gjuhë e parë e vendit, madje edhe „Zotnit e Shkupit [...] t'gjith ne nji zaa thonë se janë Shqyptarë”. *Shkupi* e qortonte

propagandën politike të qarqeve sunduese të Serbisë, e cila Kosovën e pagëzonte me emrin „*Stara Srbija*”.<sup>45</sup>

Pra, ky organ kombëtar demokratik çështjet historike i trajtoi si probleme programatike me qëllim që të luftonte propagandën e borgjezive të popujve fqinj mbi tokat e banuara me shqiptarë, që të provonte autoktoninë e shqiptarëve në Vilajetin e Kosovës, të tregonte se shqiptarët, të ndarë në tri besime „*jan të ton një zemer*” dhe vazhdimisht bëjnë përpjekje për çlirimin e tyre kombëtar. *Shkupi* i shtroi vetit për detyrë të spikas se shqiptarët mbi të gjitha e duan lirinë dhe emancipimin kombëtar.<sup>46</sup>

## 6. Lufta kundër propagandës së huaj

Në fillim të shek. XX propaganda e huaj në dëm të lëvizjes kombëtare shqiptare u shtua edhe më, e posaçërisht propaganda e borgjezisë serbe. Pas ngadhënjimit të Revolucionit Xhonturk, me pelqimin e qeverisë turke u formua *Organizata e Serbëve Osmanllinj*. Me 1 shtator 1908, ajo nxori në Shkup edhe organin *Vardar*. Me shkrimet e veta kjo gazetë e dëmtoi shumë lëvizjen kombëtare shqiptare duke dezinformuar opinionin botëror mbi këtë lëvizje. Ajo shpifte kinse serbët në shtetin turk po hiqnin të zitë e ullirit nga shqiptarët edhe pse në fakt popullata serbe në këto anë ishte më e beneficuar. Në luftë kundër lëvizjes kulturore shqiptare, ajo posaçërisht u ngrit kundër alfabetit latin për gjuhën shqipe në favor të alfabetit turko-arab. Madje ajo propozonte edhe alfabetin çirilik për shqiptarët. Kjo gazetë shqiptarët i quante „*vahshi — jabani milet*”<sup>47</sup> dhe shpifte se lëvizja shqiptare nuk është autoktone, por lëvizje e nxitur nga jashtë. Organi Shkupi duke marrë në mbrojtje çështjen shqiptare nga shpifjet e tilla, konstatonte se, për propagandën serbe edhe „*Vilaeti i Shkupit’e i Shkodrës jonë: Stara Serbia*”.<sup>48</sup>

*Shkupi* propagandën armiqësore të borgjezive ballkanike ndaj shqiptarëve e lidhte drejtë me qëndrimin e shteteve evropiane ndaj Peradorisë Osmane. Duke përkujtuar ngjarjet e viteve 1876, 1878, 1908 dhe 1911 vinte në spikamë se Rusia, Italia, Austria, Gjermania, Anglia e të tjera, shkëputën nga Perandoria tokat më të begatshme dhe ngulte këmbë se Turqinë e shkatërroi Evropa e qytetëruar prej së cilës ajo e priste ndihmën. Duke luftuar propagandën e shtypit të huaj, gazeta i thërriste bashkëkohësit shqiptarë të bashkohen si një për të vetmin qëllim: Lirinë. „*Pak jemi: dy milion e sa ktu n’Shqypni*”, të paarsimuar, të varfër dhe „*t’pa krah. Ne mram anmiq kemi boll, anmiq qie gjithkah na kan rethue, anmiq qi sidomos n’kto koh t’mrama me gazeta t’veta jan tui u mundue me na hup emnin para dynjas*.” Ngulte këmbë se shpëtimi i shqiptarëve dhe i atdheut të tyre

<sup>45</sup> Nr. 7/15 tetor 1911, f. 2. Art. „*Kosova*”

<sup>46</sup> Nr. 8/22 tetor 1911, f. 2.

<sup>47</sup> „*vahshi*” është fjalë arabe; i egër, njeri i malit, i pacivilizuar, kurse „*jabani*” është fjalë turke: i egër, i pacivilizuar. Pra, për gazetën „*Vardar*” shqiptarët ishin dyherë të egjër!

<sup>48</sup> Nr. 3/12 shtator 1911, f. 2

qëndron vetëm në bashkimin e shqiptarëve dhe në fuqinë e tyre mbrojtëse pa u mbështetur në ndihmën nga jashtë, sepse ajo asnjë herë nuk do të vijë.<sup>49</sup>

Në fillim të dhjetëvjetëshit të dytë të shek. XX në Sofje doli gazeta me emrin *Vardar* si kundërpeshë e *Vardarit* të Shkupit. Kjo gazetë përshkohej nga ide edhe demokratike dhe kishte qëndrim më të drejtë ndaj çështjes së Ballkanit. Ajo shkruante se Austro-Hungaria ka bërë marrëveshje me Rusinë dhe Italinë „për me perzan Turqin prej Evrope” dhe e njoftonte opinionin se Rusia do të merrte Dardanelet e më vonë ndoshta edhe Bullgarinë; Italia Bregdetin Shqiptar; Austro-Hungaria Luginën e Vardari gjer në Selanik. I vinte në spikamë popullit shqiptar se „pot mos hapin syt sa ma shpejt (...) t'a din sugur se jo vetum qi do coptohen, po dhe dot shuhen prej hartes n'Evrop”.

Organi shqiptar miratoi pa rezervë konstatimin e *Vardarit* të Sofjes<sup>50</sup> dhe me vendosmëri e luftoi fushatën e *Vardarit* të Shkupit, i cili midis të tjerave, mohonte edhe ekzistimin e popullit shqiptar në shumë vende të banuara ekskluzivisht nga shqiptarët. Për gazetën e dytë Shqipëri ishte „vetum afer Krojes një copë tokë. Shqiptarë tjetër kundi s'ka dhe n'Kosovë aspak!”<sup>51</sup> SHKUPI bashkëpunëtorët e kësaj gazete i quajti „çanak lëpisë të Qeverisë Serbis qi kanë strofullin këtu në Shkup”. Reagonte kundër shpifjeve të këtij organi e të atyne si mshefen mbas tij”, jo se ajo u jepte rëndësi „të lehunave të tyne, por vetum m'i dftue shumë kuej qi na i kemi syt'e haptë per çfarë do të mirë e të ligë qi n'a rrethon”. Për këto shpifje dhe propagandën armiqësore të të tjerëve në qendër të Vilajetit, fajësohej Porta që atyre u bënte të mundur atë veprimtari në dëm të nënshtetasve të saj. „Turp për qeverinë t'onë”.<sup>52</sup>

*Shkupi* kishte një vizion largpamës edhe ndaj politikës ekspansioniste të Austrisë në vendet me shqiptarë. I bënte me dije bashkëkombësit se kjo perandori do të silltet me popullin shqiptar edhe më keq se me popullin në Bosnë dhe Hercegovinë „qi një millet me anën e fes” i ndau në „tri pjesë”. I drejtohej Vjenës se „Ti ke me i nda shqiptarët ma keq se sot qeveria e Turkut e at'here do va shofim hallin e shqiptarve qi sot po lujn si molla n'ujë. E bënte me dije ministrin Berthol dhe të tjerët, që në qoftë se do të coptohet Turqia në vend të flamurit osmanllinj shqiptarët në Shqipëri do të „ngulin Bajrakun e Shqipnis, at t'a dish cok mir”.<sup>53</sup>

## 7. Qëndrimi ndaj qeverisë turke

Edhe pse doli në qendrën e Vilajetit më revolucionar, i cili Turqisë i solli aq kokëçarje se gati të gjitha vilajetet e tjera, kjo gazetë kombëtare nuk kurseu asgjë në kritikën ndaj qeverisë dhe qeveritarëve osmanllinj dhe të

<sup>49</sup> Nr. 6/8 tetor 1911, f. 1. Kryeart. *Përpara një ndarjes (thërmikje) të re mi Atdheun?!...*

<sup>50</sup> Nr. 23/1 prill 1912, f. 2.

<sup>51</sup> Nr. 28/2 qershor 1912, f. 2. Art. „*Vardar* gazeta e Kral Petros”

<sup>52</sup> Nr. 29/16, qershor 1912, f. 2.

<sup>53</sup> Nr. 28/2 qershor 1912 f. 1.

shqiptarëve turkomanë, që vepronin në dëm të lëvizjes kombëtare shqiptare. Kjo ishte luftë e vazhdueshme e Shkupit. Këtë gjë, këtij organi kombëtar, ia bëri të mundur populli kryengritës i kësaj treve, i cili e konsideronte për organ të vetin, të lëvizjes, kryengritjes. Gazeta u ngrit me shaka ironike ndaj Valiut të Kosovës, duke qoruar se ai përtëriu shtëpitë e rrënuara gjatë kryengritjes, pagoi dëmshpërblimin, vendosi nëpunësit e vjetër, me një fjalë, „qetësoi“ kryengritjen shqiptare dhe kështu „i lidhi punët me një farë peni të pamuktë“.<sup>54</sup> Me sukses e luftoi politikën shoviniste xhonturke të klubit *Shubani Vatan* që i bënte shërbime propagandës së huaj në dëm të Shqipërisë. Madje, autori anonim „Nji Shqyptar“ me një letër të hapur e sulmoi udhëheqësinë e klubit pse kishte botuar programin në gjuhën turke, bullgare, serbe dhe frenge e jo edhe në gjuhën shqipe. Duke nxjerrë helm shkruante: „U hutova, mendja m'turbullue e, tuej folë me veedi, thaçë qi ndoshta guha shqype s'asht e ktij vëndi; Shqyptarë, pas meje, Shkupi nuk kaa“. Konstatonte se bash udhëheqja e këtij klubi një vit më parë i ka kontribuar mbylljes së shkollës shqipe dhe të gazetave e klubeve shqipe të hapura pas revolucionit.<sup>55</sup>

Kjo gazetë koekzistencën midis shqiptarëve dhe të Perandorisë e shikonte si nevojë të kohës, sepse rrezikoheshin nga armiq të njëjtë. Me kohë e zbuloi fytyrën e vërtetë të partisë në pushtet ndaj çështjes shqiptare dhe i thërriste bashkëkohësit dhe patriotët shqiptarë „bashkimtar“ në radhë të parë të luftojnë për fatin e popullit të vet, për të drejtat kombëtare, shkollën shqipe, ngritjen ekonomike të vendit dhe për njohjen e shqiptarëve si „koom i gjytetnuem!“.<sup>56</sup> Gazeta sulmonte nëpunësit turq që bënë paudhësi ndaj shqiptarëve. Duke luftuar qëndrimin shovinist të Kajmekamit të Ferizajt ndaj palëve shqiptare, citonte V. Pashon: „Vjen njeri i huaj e t'ri n'voter, për m't turpnu me grue me moter!“ dhe kërkonte nga Valiu që ai të marrë masa kundër atij kajmekami i cili jo vetëm që kishte nëpërkëmbë „kanunin ndërkombëtar [...], ka mar nen kom nerrin e nji komit nga cili kom mbahet nderi mretnis“.<sup>57</sup> Shkupi e sulmoi qeverinë turke dhe e akuzoi para opinionit se po i përgatiste varrin Shqipërisë dhe lirisë nacionale të shqiptarëve dhe se kishte për qëllim që „sa ma shpejt“ t'ia shlyente emrin „nga harta e Evropës“.<sup>58</sup> Kërkonte nga Stambolli që administratorët në shqipëri të mos keqtrajtojnë e nëpërkëmbin popullin shqiptarë, mos ta ndiejnë veten si Luigji XIV: „Mbretnia jam vet!“ dhe aludonte drejt: „sundimtari do t'een i popullit (shqiptarë — MP) e populli i sundimtarit!“.<sup>59</sup> U ngrit kundër reformave dhe personave që ato duhej t'i vinin në jetë në Shqipëri dhe Maqedoni. Konstatonte se nga viti 1839 deri më 1912 për viset më shqiptarë ishin projektuar 102 projekte të reformave e të cilat nuk

<sup>54</sup> Nr. 3/12 shtator 1911, f. 2 Art. „Valiu dhe Gjakova“.

<sup>55</sup> Nr. 9/29 tetor 1911, f. 1. Art. „Letër t'hapun Zotni Kreut t' Klubit Shubani Vatan“

<sup>56</sup> Nr. 11/16 nëntor 1911, f. 1.

<sup>57</sup> Nr. 12/8 dhjetor 1912, f. 2.

<sup>58</sup> Nr. 16/17 janar 1912. Art. „Jahu tani sa asht moti arabie“

<sup>59</sup> Nr. 19/20 shkurt 1912, f. 2.

parashihnin „*asgjë për Shqipërinë*“. Ajo shprehte mosbesimin ndaj komisioneve të caktuara për t'i vënë në jetë disa reforma në vitin 1912. Theksonte se anëtarët e komisioneve kanë ardhur vetëm për një qëllim — korrupcion. „*Koha do na kallzon t'verteten si do kullon dhe kjo dallavere'e kohes re*“.<sup>60</sup> Duke botuar aludimin e ushtarakut dhe qeveritarit Mahmud Shefket Pashës: „*Shum o ma e udhës qi t'i shtypim kryet e ti shueim sa me shpejt Shqiptarët*“,<sup>61</sup> u vinte në spikamë bashkëkohësve se qeveritarët osmanllinj nuk kishin hequr dorë nga ky qëndrim armiqësor, andaj për rezistencë duhet bashkimi shqiptar. Madje, duke u ngritur kundër udhëheqësit të ekspeditës ndëshkuese të vitit 1910 në Kosovë e gjetkë në vendet me shqiptarë, Mahmud Shefketit, thërriste: „*Mjaft rjepe djersen e fakir fukara milletit Osmanlli*“.<sup>62</sup> Gazeta demantoi edhe gënjeshttrat kinse qeveria turke do të vendoste nëpunës shqiptarë në Shqipëri dhe i ftonte shqiptarët në emigrim që të mos u besojnë trillimeve të tilla, sepse Turqia asgjë nuk do t'u „*dhuroid*“ shqiptarëve po ata nuk i muarën vetë me anë të pushkës.

Duke shkruar për vlimin revolucionar të masave shqiptare dhe të kërkesave të tyre, kjo gazetë i kontribuoi thellimit të jazit midis shqiptarëve dhe qeverisë. Njoftonte opinionin se shqiptarët janë të vendosur për ta ndërruar rendin shoqëror qeveritar se më „*në xhemiet zdum*“.<sup>63</sup> Me guxim të pashoq atakoi mbi Valiun e Kosovës, pejanin Mazar Beun, i cili nuk kuptonte intrigat e të tjerëve në dëm të vendit, bile e quajti gomar i mbyllur „*në Sarajë poshtë Vardarit*“, sepse për kohën prej tetë muajsh, sa ishte Vali, nuk kishte sjellë „*sa një fitim për mretni dhe aspak për Shqipni*“.<sup>64</sup>

## 8. Qëndrimi ndaj partive politike

Ky organ kombëtar nuk pranonte për popullin shqiptar asnjë parti politike në Turqi. Theksonte se ato nuk janë shqiptare dhe se nuk punojnë për Shqipëri. Posaçërisht e luftonte partinë politike *Xhemiet* (Bashkimi), por nuk e kursente as partinë politike *Ittilafi Hyriet* (Liri e Marrëveshje). E luftoi edhe Komitetin *Ittihad ve Tareki* (Bashkim e Përparim) dhe shoqërit politike dhe kulturore turke. U ngrit kundër inskenimit të qeverisë për zgjedhjen e deputetëve joshqiptarë në viset me shqiptarë dhe të shqiptarëve fanatikë turkomanë. I thërriste bashkëkohësit të jenë syçelë, sepse *Xhemieti* „*me qiri po i kërkon me gjet anmikt e Shqiptarëve dhe t'bashkohet me ta kontra Shqiptarëve dhe emnit Shqipëtar*“.<sup>65</sup> Duke larguar mundësinë e bashkëpunimit të shqiptarëve me partitë politike turke, vinte në pah se qëndrimi i një partie politike ndaj një populli gjykohet në bazë të veprës se çka ka bërë ajo

<sup>60</sup> Nr. 20/1 mars 1912 f. 1.

<sup>61</sup> Nr. 24/11 prill 1912, f. 2.

<sup>62</sup> Nr. 3/3 qershor 1912, f. 2. Art. „*Mjeker sqapi Mahmud Shefketi*“

<sup>63</sup> Nr. 25/23 prill 1912. Art. „*Gjakova dhe hyqymeti*“

<sup>64</sup> Nr. 30/3 korrik 1912, f. 2. Art. „*I pari i kti Vilaeti*“

<sup>65</sup> Nr. 18/8 shkurt 1912, f. 2.

parti për atë popull që i është bindur. Konstatonte se *Xhemiet* është sjellë në mënyrë të pabesë „*faje kombit t'onë*”. Duke u mbështetur në veprën kriminale të Komitetit *Bashkim e Përparim* ndaj çështjes shqiptare vinte në dyshim edhe sinqeritetin e *Ittilafi Huriet*. Theksonte se *Xhemiet* për katër vite në pushtet, Shqipërinë e çoi „*në buzë të vorrit*”. Konstatonte se shqiptari nuk mund të bëhej anëtar i *Xhemietit* „*po s'kje anmik i rrept'i kombësisë s'onë*. Vinte në spikamë se tradhtarët e popullit shqiptar „*ushqehen prej Xhemietit e rrhojnë si bejlerë, oxhakzade e pashallar vetum të punojnë kundër përparimit t'shqipëtarëve*”.<sup>66</sup>

*Shkupi* nuk parashihte mundësinë e bashkëpunimit të shqiptarëve me partitë politike turke edhe për arsye se të gjitha partitë politike turke ishin në marrëdhënie të mira politike e „*vëllazërore*” me të gjithë armiqtë e jashtëm të Shqipërisë, me të gjitha ato fuqi reaksionare të Ballkanit, të cilat pretendonin në tokat e banuara me shqiptarë dhe maqedonë. Veçmas e kundërshtonte marrëdhënien „*vëllazërore*” të partive turke me shtetin serb dhe u ngrit kundër bartjes së armëve për Serbi nëpër tokat e Perandorisë të banuara me shqiptarë pasi: „*jemi sugur qi me ato armë s'qellon tjetër por me j'u sulmue Shqipënis*”. Përfundonte duke iu drejtuar bahkëkohësve atdhetarë: „*A mundemi na bijt'ë Shqipënis të miremi vesh me partia? Të vën gjitë e cila Shqypëtar doren në zemër e të përgjeqin!*”

Derisa ndaj *Xhemietit* nuk linte kurrfar mundësish për bashkëpunim, ndaj *Ittilaf* — i *Hyriet* parashihet një mundësi — luftë të përbashkët me atë kundër *Xhemietit*. Partinë e *Ittilaf-it* e quante „*armik të armikut tonë*” dhe vinte në spikamë se as ajo parti asgjë nuk kishte bërë për popullin shqiptar dhe se ajo ishte duke bërë përpjekje të zgjidhen deputet „*prej Shqipnijet njasi qi s'kanë faret ndjesina kombiare por per kundrazi janë kundërshtuar të Shqypetarizmit!*” Me bindje revolucionare i thërriste anëtarët shqiptarë të *Ittilafit* të vinin gishtin në „*tamthe e mos të habiten me harrue kombësin e tyn'e punue kontra interesave të kombit, tuej qurmue mbas dishirave të një shoqënisë që s'asht Shqypetare!*”. Përfaqësuesve të popullit shqiptar në qeveri u vinte në dije se po nuk punuan në interes të çështjes kombëtare populli ka mundësi me ua marrë besimin dhe „*fuqin*”.<sup>67</sup>

Në vitin 1912 në Stamboll ishte ngritur një organizatë revolucionare kundër *Xhemietit*. Në krye të organizatës qëndronte *Pertef Beu, reis në erkjani-harb* (Kryetar i Këshillit të Luftës). Kjo organizatë bëri përpjekje t'i përfitonte shqiptarët në saje të pakënaqësisë që kishte shkaktuar qeveria e xhemijetlinjve në Shqipëri. *Shkupi*, si gjithmonë vigjilente, në emër të popullit shqiptar u përgjegj drejt: „*Nj'qint partia e organizacia t'boheni, prap hair s'keni me bo, os t'ton punat i keni falsh (sahte) ashtu o dhe kjo e tanishme*”.<sup>68</sup> Gazeta preferonte për popullin shqiptar një parti politike — *Bashkimin kombëtar shqiptar për liri dhe pavarësi*.<sup>69</sup>

<sup>66</sup> Nr. 23/1 prill 1912, f. 1. Kryeart. „*A mundemi të miremi vesh me Xhemiet dhe me Ittilafi huriet!*”

<sup>67</sup> Nr. 24/11 prill 1912, f. 1. Kryeart. „*Mos të harrojmë kombësinë!*”

<sup>68</sup> Aty. Art. „*Një organizacie n'Stamboll!*”

<sup>69</sup> Aty. Shih *Shkupi* Nr. 30/1912, 1.

## 9. Mendimi ndaj hakmarrjes

Ky organ që dilte në trevën ku më shumë ishte i pranishëm fenomeni i hakmarrjes, luftonte në mënyrë të rreptë kundër vëllavrasjes dhe mbytjeve në tërësi. Traditën e hakmarrjes e kualifikoi si „*nji ner të zezat ma të mdhaja që kemi n' Shqypni*“. Hakmarrjen e trajtoi si armikun më të keq të kombit dhe vinte në spikamë se vetëm për një vit vriten më së paku 600 burra, luftëtarë të ardhshëm të lirisë të cilët nesër do të ishin „*lumni e madhnii e Shqypnis*“. Gazeta aludonte të ruhet gjaku i vëllazërve, gjaku ynë „*se shum t' kushtushum e kemi: kemi se pershka me e derdhë, hiç pa dhimt, due me than për Vatan ... për lumni, per madhnii ton!*“ Dhe, „*Mallku kjoft pra gjaku, mallku kjoft vrasa, e rrhoft dashnia, rrhoft vllaznia e Shqyptarëve!*“<sup>70</sup>

Mendimi politik e shoqëror i gazetës lidhur me zhdukjen e hakmarrjes është i shëndoshë, burimor, vizionar dhe i avansuar. Shkaku i dukurisë së vllavrasjes dhe të hakmarrjes, sipas Shkupit, buronte nga prapambetja dhe mosarsimimi i popullit. Ajo theksonte se vetëm arsimi i tërësishëm është faktor që mund t'ia shkurtojë rrënjët hakmarrjes, sepse tani njerzit nuk do të vriten nga kokëfortësia dhe gjaknxehtësia. Duke folur për mbaresën pajtimin që kish bërë Valiu i Kosovës në Lumë, duke pajtuar *Cen Elezin* me *Cen Dacin* „*t'cilt dhun e marri t'madhe i kan sjell kombit, vetes [...] tui vra shoqi shoqin [...] mbi se 200 vet*“ — theksoi nevojën për hapjen e shkollës kombëtare si kusht për ta zhdukur hakmarrjen dhe me ironi apostrofoi: „*Mir boni Valia q'i pajtoi kto dy Shqiptar; po duhet Valia tu kshillon për hapjen e një mektebit shqip n'ato vende, se athere do kishte bo Valia një shërbim ma t'math si mretnis ashtu dhe kombit Shqipetar!*“ Vinte në pah se shërbime të atilla, mbaresa, kishin bërë edhe qeveritarët dhe administratorët e tjerë, por pa kurrëfarë dobie për Shqipërinë dhe Mbretërinë.<sup>71</sup>

## 10. Qëndrimi ndaj kryengritjes shqiptare

Lëvizja e armatosur, që filloi në vitin 1909 në Kosovë, sa vinte e përhapej, sa që, në fillim të vitit 1912 përfshiu të tëra viset e banuara me shqiptarë. Shkupi përcolli këtë lëvizje në çdo hap, shkroi për aksionet e kryengritësve, kërkesat e tyre, për udhëheqësit dhe strategët më në zë politik dhe luftarak. Ajo ishte në luftë të vazhdueshme kundër shpifjeve të propagandës së huaj, e cila luftëtarët shqiptarë për liri i quante rebelë, turbullues e asgjë tjetër dhe konstatonte se ato çeta përtizanësh janë çeta të luftëtarëve kombëtarë „*t'cilat punojnë për lirin e Shqipënis!*“<sup>72</sup> Duke folur për kryengritjen e vitit 1912, e cila po i afrohej pavarësisë, me mburrje e

<sup>70</sup> Nr. 20/1 mars 1912, f. 1. Kryeart. „*Vrasa n' Shqypni*“

<sup>71</sup> Nr. 24/11 prill 1912, f. 2. Art. „*Mazar Begu dhe Luma*“

<sup>72</sup> Nr. 20/1 mars 1912, f. 2.

njoftonte opinionin se kryengritja e kishte përfshirë Gjakovën, Pejën, Gucinë, Prishtinën, Preshevën, Prizrenin, Ohrin dhe Matin me qendër të kryengritjes në Junik. Kjo vine në spikamë se „*Kryengritësit jon me mi e po shtohen dit me dit, si gjethtë e pemve*”. Kundër këtyre luftëtarëve, shkruante gazeta, qeveria kishte dërguar tridhjetë batalione ushtarësh. Megjithatë, kryengritja po merrte përpjesëtime edhe më të diferencuara.<sup>73</sup> Me krenari konstatonte se „*Shqiptarët shoqi me shoqin besim t'madhë ka e s'ka q'i ndan dhe sa do durojë aqë ma vyeshme do bohet kjo çeshtje!*” Flamurtari i luftës për çlirim kombëtar sipas *Shkupit* ishte Isa BOLETINI, i cili e dha kushtrimin e njohur midis popullit: „*Për Liri — Deri në vdekje!*”

Kushtrimi i Isasë i tuboi patriotët nga të gjitha viset e banuara me shqiptarë në Vilajetin e Kosovës. Besa sa vinte e përfshinte territor më të gjerë, sa që „*ke Isa Boletini n'Drenicë*” kishin arritur delegacione nga Plava, Gusia për të dëshmuar se populli i atyre viseve janë të vendosur të hyjnë nën Flamurin e Isas „*për një luftë t'rept kontra qeverimit paudhë!*”<sup>74</sup> Topografia e kryengritjes, në muajin korrik 1912, përfshinte këto pika strategjike dhe ekonomike: Prizrenin, Lumën, Gjakovën, Gusinë, Prishtinën dhe kufirin e Shkodrës.<sup>75</sup> Konstatonte se „*liviza o shtri n'ton Gegnin*”, por luftërat më të rrepta po zhvilloheshin në Istok, Pejë, Junik, Gjakovë, Boletin, Has, Qafa Prushit e gjetkë.<sup>76</sup>

Ky organ u ngrit në mënyrë të rreptë kundër mizorive të ushtrisë dhe qeverisë turke ndaj familjeve të kryengritësve. Me pezmin më të madh konstatonte se: „*Grat, çikat, çunat e ton kryengritsvet shqiptar i ka zan qeveria e mallkume e i ka sjell n'Shkup*”, midis të tjerave: të Riza Beut, Bajram dhe Hysni Currit, Ahmet beut dhe të Jahja agës nga Gjakova, të Shaban beut, Jahja beut, Musa Efendiut e të Sadik Efendiut nga Prizreni, të Mahmut Zajmit e të tjerëve nga Peja. Shkupi me ironi të theksuar qëllonte: „*alla 600 vjet vllaznia paske zan temel me rranjë n'mes ktyneve dy kombe qi s'kan kurgjo n'met*. E sulmonte qeverinë turke pse ajo nuk ishte e zonja të çohet dhe t'i luftone çetat bullgare terroriste e në anën tjetër „*mbi Shqyptarë musliman po don m'e bo tatbik*”<sup>77</sup> ... Peni ku o ma i holl aty kputet e dim dhe ne atë.”<sup>78</sup>

Në muajin korrik 1912 kryengritësit në Kosovë e kishin në dorë tërë situatën në terren, kurse në muajin gusht formuan *këshilla popullor* për mbledhjen e ndihmave për luftën përfundimtare dhe shpalljen e pavarësisë. Sipas të dhënave të SHKUPIT tërë lëvizja qëndronte në duart e njerëzve kombëtarë: në Gjakovë të Bajram Currit, Riza beut, Ahmet beut, Bajram Daklanit, Hysni Currit; në Pejë të Mahmut Zajmit, Qerim beut, Rustem beut, Bahri beut; në Prizren të Shani beut, Musa Shehut, Jahja beut; në

<sup>73</sup> Nr. 27/15 maj 1912, f. 2. Art. „*Lëvizjet n'Shqypeni*”

<sup>74</sup> Nr. 28/2 qershor 1912, f. 2. Art. „*Gjendja në Shqipni*”

<sup>75</sup> Nr. 29/16 qershor 1912, f. 2.

<sup>76</sup> Nr. 30/3 korrik 1912, f. 2. Art. „*Kryengritsit shqiptar*”

<sup>77</sup> Fjala „*tatbik*” ka kuptimin e fjalës: të shtypë, të zbatojë.

<sup>78</sup> Nr. 30/3 korrik, 1912, f. 2. Art. „*Familjat e Kryengritsivet*”

Mitrovicë të Boletinit me tre djemt e me tre nipat; në Vushtrri të Hasan beut, Zejnullah beut dhe të Maxhunajve; në Prishtinë të Xhemail beut, Abdurrahmanit, vëlla i Shaban Pashës, Ahmet Dakës, Ibrahim Kokolit; në Gjilan të Salih agës, Bejtullah beut; në Preshevë të Idriz Seferit, Kasem Seferit, Hysein Litës; në Tetovë të Halim beut, Abdurrahman beut; në Gostivar të Qemail beut; në Kërçovë të Ali Durgomishtës; në Elbasan të oficerit Doktor Xhafer beut; në Korçë të oficerit Lutfi beut; në Shkup të Qemal beut, Menduh beut, Ali Efendiut dhe të Adil Efendiut. „*Kto Zotni e atdhetar qi po i shenojmë ma sipër ish-in krenat e Shqipnis (e të) Vilaetit Kosovës të cilt kapn armet me prujt nderin dh'emnin e Shqipnis. Istoria*”. U uronte sukses kryengritësve që ia dolën të hapin depot e municionit për të armatosur vullnetarë të rinj të lirisë.<sup>79</sup>

Në gusht 1912 kryengritësit çliruan qendrën e Vilajetit, dhe përgatiteshin për çlirimin e vendeve të tjera. *Shkupi* kryeqendrës i uronte çlirimin dhe njoftonte opinionin se i pari në Shkup depërtoi Bajram Daklani me 200 pushkë, e pas tij: Bajram Curri e Halim be Gjakova me 5000 pushkë, Riza beu me 7000 pushkë, Salih agë Gjilani me 1000 pushkë, Halim be Tetova me 2000 pushkë, Shani be e Islam Spahiu me 4000 pushkë, Isa Boletini e Mendu beu me 3000 pushkë, Qerim beu e Bahri beu nga Peja me 200 pushkë, Ahmet beu me 1000 pushkë, Abdi beu Toptani, Marka Gjoni, Riza Dani, Mane be Leshi e Mustafa Kroja me 100 pushkë dhe si delegatë të Shkodrës.<sup>80</sup> Kryengritësi shqiptarë marrshonin duke ngritur lartë flamurin kombëtar. Shkupi e ngriti lartë gjestin e haxhi Abdulla Gjakovës, i cili, i përcjellë nga shumë atdhetarë kishte hyrë në Klubin e Oficerëve dhe i kishte nxjerrë me dhunë jashtë oficerët turq: „*Deri tash ke e juaja, sot e masandej asht e jona*”.<sup>81</sup>

Fitoret e njëpasnjëshme të kryengritësve mbi ushtrinë turke i siguruan të gjitha kushtet për shpalljen e pavarësisë së shtetit shqiptar. Mirëpo, mu në kohën kur shqiptarët duhej të kurorëzonin luftën me shpalljen e pavarësisë zyrtarisht, borgjezitë e vendeve fqinje, të përkrahura nga Rusia e shtete të tjera, duke u frikësuar se viset me shqiptarë u dolën njëherë e përgjithmonë nga dora, shpejtuan përgatitjen e Aleancës kundër Turqisë, e më drejt, kundër Shqipërisë, pasi faktikisht ajo ishte në këmbë të veta. Gazeta *Shkupi*, ka gjasa, në numrin e fundit të saj, në prag të luftërave ballkanike dhe të copëtimit të viseve me shqiptarë dhe maqedonë, konstatonte: „*Për çark të kufinjve të Shqipënisë nde katër vilajetet: Shkodra, Shkupi, Manastiri dhe Janina (...) (ku janë të banuara me shqiptarë — MP) armiqtë po ulurasin (...) nga shkaku se Shqiptarët me huta nde dorë tuk me pasur nde krye të tyre ata bajraktarë të shenuar e trëma të kqinj, generallë të pa frikë; Shqiptarët kërkajnë turkut t'ju njohi kombësinë e tyre zyrtarisht, se kombësinë e kanë mbrojtur me gjak të tyre...!*”<sup>82</sup> Kështu, Shkupi, edhe në

<sup>79</sup> Nr. 32/30 gusht 1912, f. 1. Art. „*Kryengritësit e Shqipnis*”

<sup>80</sup> Nr. 33/19 shtator 1912, f. 2.

<sup>81</sup> Nr. 32/30 gusht 1912, f. 2.

<sup>82</sup> Nr. 6/8 tetor 1911, f. 2.

fund të jetës së vet vërtetoi se ka qenë organ dhe buletin besnik i lëvizjes dhe kryengritjes kombëtare për pavarësinë e atdheut.

### 11. Vizioni dhe qëndrimi ndaj politikës pushtuese të borgjezive Ballkanike

Ky organ pa humbur në kohë i nxori në shesh planet pushtuese të qeverive ballkanike ndaj vendeve me shqiptarë. Duke nxjerrë mësim nga historia pohonte se Turqinë, ose Shqipërinë, kanë për ta copëtuar si plaçkën „*miqët e Turqisë*” — Sërbia, Bullgaria, Mali i Zi dhe Greqia.<sup>83</sup> Për këtë qëllim ishte ngritur edhe Lidhja Ballkanike.<sup>84</sup> *Shkupi* aleancën serbo-bullgare kinse për çështje ekonomike dhe për afrimin e serbëve me bullgarët, me të drejtë e quajti aleancë kundër Turqisë për t'u shtrirë në Shqipëri dhe Maqedoni.<sup>85</sup>

Mirëpo, gjithësesi, aspiratat e borgjezisë serbe i rrezikonin më drejtpërdrejt vendet me shqiptarë. Qeveria serbe kishte organizuar një rrjet të posaçëm spiunazhi, organizata dhe komitete serbe, të cilat punonin në përgatitjen e terrenit për pushtimin e tokave të reja në Vilajetin e Kosovës të Manastirit dhe të Shkodrës. Propaganda serbe kishte në program edhe kompromitim dhe dobësimin e lëvizjes kombëtare shqiptare. Organizator i saj propagande ishte Tiça Popoviq,<sup>86</sup> kurse komiteti, me program më megaloman quhej *Bashkim o Vdekje* i formuar në muajin tetor 1911. Organi kombëtar *Shkupi*, duke u ngritur kundër pretendimeve të tilla ekspansioniste të Serbisë, konstatonte se: „*Serbve u ka hy një megalomani dhe kujtojn se qi nga Stambolli e gjer n'Wien, edhe qi nga Tuna gjer n'Adriatik, jo vetum qi njërzit jon serb, po edhe gurët.*”<sup>87</sup> Ky organ me të drejtë vuri në spikamë se politika pushtuese e Serbisë nuk mbështetej në fuqinë ushtarake të Serbisë, përballë shqiptarëve, por pas saj qëndron Rusia cariste. E informuar nga „*mburim t'Rusisë*” konstatoi se Serbia prej vitit 1908 ishte forcuar ushtarakisht dhe sipas bindjes të „*baballarëve të Moskovit në kohën e luftës*” mund të nxjerrë 285.000 ushtarë dhe 348 topa.<sup>88</sup> Duke sulmuar qeverinë turke, e cila nuk ishte e zonja të shihte edhe pas perdeve të zeza diplomatike „*e cila politikë randon një shuplak të madhe jo vetum mbi krye të Shqypnisë, por edhe krejt Mbretnis*”. *Shkupi*, e njoftonte opinionin se në Serbi janë formuar shoqëri për të provokuar dhe shkaktuar avari të ndryshme politike dhe ekonomike në Kosovë për ta shpejtuar aktin e pushtimit të Vilajetit të Kosovës. Gazeta, njëkohësisht

<sup>83</sup> Po aty.

<sup>84</sup> Nr. 7/15 tetor 1911, f. 2., Nr. 6/1911, f. 2.

<sup>85</sup> Nr. 9/29 tetor 1911, f. 2.

<sup>86</sup> Nr. 7/1911, f. 2. **T i ç a P o p o v i q i** n, më 1912 në Beograd, e ka rrahur pejani i quajtur **F i l i p**. Ky ishte në punë në Tashlixhe (Plavë) dhe me ndikimin e Popoviqit ishte nxjerrë nga puna. Për këtë rast Filipi u hakmor mirë në Popoviqin. Këtë gjest e pëlqeu „**SHKUPI**” dhe konstatoi: „*I lumt krahi kti shqipëtar ortodoks*”.

<sup>87</sup> Nr. 9/29 tetor 1911 f. 1.

<sup>88</sup> Nr. 11/16 nëntor 1911 f. 2.

vinte në spikamë se Ministri i punëve të jashtme i Serbisë „*me miliona asht tuj prish nder vise t'ona per propaganden serbe*”. Me qindra spiunë kishin ardhur në Kosovë dhe vepronin haptas dhe në bashkëpunim të plotë me xhonturqit „*kundra Shqypëtarëve e Shqypënisë*”.<sup>89</sup> U ngrit kundër çetave të armatosura të Serbisë, të lëshuara në Vilajetin e Kosovës, për të nxitur armiqësi midis popullit shqiptar dhe të serbëve osmanllinj „*tue bo zullum terma të posht*” dhe i thërriste bashkëkohësit: „*Hapni syt tue pruit Vatanin dhe rept tu kondrashtoheni ktyneve zullumkiar t'cilët i dergon Serbia knei! Shkupi ishte për bashkëjetesë paqësore e vëllazërore midis popujve që aso kohe gjendeshin në Kosovë.*”<sup>90</sup>

Ky organ ishte vigjilent për situatën e krijuar nga fuqitë e mëdha dhe shtetet ballkanike. Për të, Perandoria Osmane qëndronte vetëm përkohësisht, pasi nga të gjitha anët ishte e rrethuar nga armiqtë. Bënte me dije atdhetarët shqiptarë se Aleancës Ballkanike synonte t'i bashkohej edhe Austro-Hungaria „*me shpresa t'ndain dhe kto copa t'atdheut ton qi kan met pa coptu*”. Në mënyrë revolucionare demokratike iu drejtua opinionit dhe qeverive që pretendonin në tokat e banuara me shqiptarë se populli shqiptar nuk do të pranojë të mbetet nën sundimin e Bullgarisë, Serbisë, Austrisë, Italisë, Greqisë e të tjerëve dhe kërkonte nga qeveria turke që të plotësonte kërkesat e shqiptarëve, t'u njohë kombësinë, t'u lejojë shkollat kombëtare të financuara nga qeveria, të zhvillojë ekonominë, të ngrehë ferrovit dhe të bëjë rrugë për komunikacion dhe përfundonte: „*E pra, Mretnia e pa vonu e sa ma shpejt ti mushnje deshirat e kerkimet jo vetum qi bojme neve, po dhe t'on Shqipënis deri ku shtrihet guha jon. Pa komentat!??*”<sup>91</sup> Kjo ishte garanci e vetme për ruajtjen e tokave me shqiptarë në rrethana të krijuara në prag të luftërave ballkanike.

Propagandën politike të qeverive ballkanike në dëm të popullit shqiptar e ndihmonte edhe propaganda e kishës. Duke shfrytëzuar ndarjen fetare të popullit shqiptar në tri besime, kishat e besimeve të ndryshme ishin bërë instrument në duart e armiqve për të thelluar edhe më shumë hullinë midis shqiptarëve që më lehtë t'i ndanin tokat e tyre. Megjithatë, më aktive ishte propaganda e kishës serbe. Kjo kishë, me ndihmën e kishës greke, dhe me ndihmën e „*përdhun (...) të hyqymetit*” të Turqisë kundër shqiptarëve, shqiptarët e besimit ortodoks të fshatit Klejn të Dibrës së Sipërme i „*bëri*” serbë, u dërgoi priftin serb dhe filloi serbizimin e tyre të plotë.<sup>92</sup>

*Shkupi* përpjekjet e borgjezive të vendeve fqinje për copëtimin e vendeve me shqiptarë gjithmonë i shihte në konstelacion me kërkesat e tilla të qeverive të shteteve të mëdha evropiane. Madje ishte e sigurt se kundër popullit shqiptar vepronte tërë borgjezia evropiane dhe se shqiptarët nuk

<sup>89</sup> Nr. 23/1 prill 1912, f. 1.

<sup>90</sup> Nr. 24/11 prill 1912, f. 2.

<sup>91</sup> Nr. 29/16 qershor 1912, 2.

<sup>92</sup> Nr. 12/8 dhjetor 1912, f. 1.

kishin mundësi të bënin marrëveshje me asnjë shtet fqinj dhe të Evropës. Në një situatë të tillë parashihte të vetmen mundësi për marrëveshje, për t'i shpëtuar rrezikut nga jashtë „*sot per sot asht vetem Turqia, pot kuptojn Turqit e marrë*” të cilëve u kanoset i njëjti rrezik. E bënte me dije opinionin se edhe në rast se shpartallohet Perandoria, gjë që është e paevitueshme, shqiptarët do të punojnë „*p'asnjë cmir e komplimente po me plot e vetum per interesin e Shqypnis!*” E revoltuar në Evropën e qytetëruar, e cila gjithmonë për popullin shqiptar ishte njerjë e shtrigë, qëllonte me ironi: „*Shqipnin se do askush, dhe kujtojmë se se do e e ka harru dhe Perëndia!*”<sup>93</sup>

## 12. Vizioni dhe qëndrimi ndaj politikës kolonialiste të fuqive të mëdha

Lufta e *Shkupi* kundër politikës kolonialiste të shteteve të mëdha ndaj tokave nën Perandorinë Osmane ishte permanente. Ajo e kishte të qartë se Turqisë „*i ka ardhur dita t'coptohet fare, dhe n'Evrop ka me lon emnin q'ka pas kon njiher Turqia knei*”.<sup>94</sup> Për tokat nën të, kishin lidhur interesat të gjitha fuqitë koloniale, por më shumë rrezik paraqiste pansllavizmi rus. Gazeta vinte në pah se Rusia „*prap na qet dhambetë po do me na hypë në krye*”,<sup>95</sup> por qeveria e verbër turke nuk ishte në gjendje të kuptonte, bile bëri marrëveshje me qeverinë e Petrogradit për të krijuar një „*lidhje politike (...) per tu pru ngà anmiku q'jasht*” me kusht që Turqia „*t'ep fund grindjes qi bonet në Vilajet t'Kosovës e Shkodrës kontra Serbve nga ana e Shqiptarëve*”. Ajo vinte në spikamë se intrigat kinse serbët osmanllinj po vuanin nga shqiptarët, *Shkupi* i luftoi me të drejtë dhe konstatonte se serbët osmanllinj janë populli më i privilegjuar, me shkolla e shtyp të vetin dhe se jazin midis shqiptarëve dhe serbëve vendës është duke e thelluar propaganda e Serbisë. Konstatonte se në marrëveshjen Ruso-Turke „*ka brenda dhe shum andra t'Serbiis!*”<sup>96</sup> Vinte në pah se në Rusinë cariste kultivohen dy rryma politike — e pansllavistëve dhe e kabinetit. Pansllavistët kanë për program largimin e Turqisë nga Evropa dhe zgjerimin e shteteve sllave në Ballkan, të Serbisë, Bullgarisë dhe të Malit të Zi në tokat e banuara me shqiptarë dhe me maqedonë. Politikën e jashtme të këtyre shteteve do ta dirigjonte, Rusia. Njëri ndër zbatuesit e programit pansllavist të Ruisë në Ballkan ishte ambasadori i Ruisë Çarikof, inskenuesi i atentatit ë vitit 1903 mbi mbretin Aleksandër dhe mbretëreshën Draga Karagjorgjeviq.<sup>97</sup>

Organi kombëtar i lëvizjes në Kosovë nuk e kurseu as *Italinë*, e posaçërisht *Austro-Hungarinë*. Me rastin e përpjekjes të qeverisë së Vjenës

<sup>93</sup> Aty. Art. „*Si mendojnë armikti per ne*”

<sup>94</sup> Nr. 7/15 tetor 1911, f. 1. Konstatim i gazetës „*Le Matin*”

<sup>95</sup> Nr. 4/19 shtator 1911, f. 1. Konstatim i gazetës „*Silah*”, Selanik, më 7 shtator 1911.

<sup>96</sup> Nr. 7/15 tetor, 1911, f. 1.

<sup>97</sup> Nr. 23/1 prill 1912 f. 12.

për të rënë në ujdi me qeverinë e Beogradit dhe të Cetines lidhur me coptimin e vendeve me shqiptarë, me ironi i drejtohet Austrisë. „*mikut të shqiptarëve të besimit katolik!*” „*Po dhe ti moi Austri po bashkohesh me anmikt e vjeter sllav kontra Shqipnis pa mos sjell n’ment proteksionin jot ke shqiptarët katolik*” dhe me të drejtë qëllonte: „*At’here po sillesh me shqiptarët katolik si Juda me Krishtin!*”<sup>98</sup> Bile *Shkupi* shkoi edhe më larg. Ministrin e plotfuqishëm të Austrisë, Bertholdin e quajti „*dhelpra e vjetër*” dhe u ngrit edhe kundër politikës së Gjermanisë dhe planeve të saj kolonialiste në Ballkan.<sup>99</sup>

Ndaj çështjes shqiptare pak më i matur, sipas *Shkupi* ishte patroni besnik i Greqisë, Anglia. Qeveria e Londrës e këshilloi Portën „*që t’i jep Shqipënisë Autonomi — Muhtariet*” nën mbikëqyrjen e Stambollit.<sup>100</sup> Këtë politikë Anglia e ndiqte për kundërpeshë të pansllavizmit e jo për interes të Shqipërisë. Ndaj problemit shqiptar dhe të Ballkanit të paçliruar qëndrim më të drejtë, demokratik dhe miqësor ka treguar qeveria dhe opinioni i Rumanisë. Gazeta e Bukureshtit *Universul* e datës 6 nëntor 1911, theksonte se çështja e Shqipërisë dhe e Maqedonisë nuk është vetëm në duart e Austrisë dhe të Rusisë, por është „*nji merje e madhe e Evropës*”. Madje, kjo gazetë insistonte ke qeveria turke që shqiptarëve t’u linte në disponim 400 mijë pushkë të tipit mauzer „*qi t’ruajn vatanin e vet nga robnimi i huaj po’jet mi Shqipëni*”, me forca të veta.<sup>101</sup>

Sa ishte *Shkupi* vigjilent ndaj rrezikut të jashtëm kolonialist mbi Shqipërinë dhe Maqedoninë shihet edhe nga konstatimi i saj se Shqipëria dhe Maqedonia janë bërë kopsht për t’i luajtur atllarët Vjena dhe Peterburgu dhe i thërriste popujt e këtyre dy provincave të Perandorisë që të përgatiteshin për luftë të përbashkët kundër cilitdo armik që t’u versulej.<sup>102</sup>

### 13. Konceptioni mbi përfaqësimin e popullit

Mendimi politik e shoqëror i kultivuar në gazetën *Shkupi* lidhur me konceptimin mbi përfaqësimin e popullit ishte i orientuar krejtësisht në interes të çështjes kombëtare. Për këtë organ, përfaqësues të popullit mund të ishin vetëm ata persona që kishin dalë nga gjiri i popullit dhe tërë aktivitetin politik dhe veprën ia kushtonin popullit dhe atdheut. Të tillë ishin, në Vilajetin e Kosovës, Danish Prishtina, Bajram Curri, Nexhib Draga e Hasan Prishtina, të cilët „*tepër jan marr në punet ’e atdheut*”.<sup>103</sup> *Shkupi* shkante haptazi kundër qeveritarëve dhe parlamentarëve më të njohur turq dhe turkomanë, veprimtaria politike e të cilëve ishte e

<sup>98</sup> Nr. 29/16 korrik 1912 f. 2.

<sup>99</sup> Nr. 28/2 qershor 1912, f. 1.

<sup>100</sup> Nr. 27/15 maj 1912, f. 2.

<sup>101</sup> Nr. 12/8 dhjetor 1911, f. 2.

<sup>102</sup> Nr. 11/16 nëntor 1911, f. 2.

<sup>103</sup> Nr. 5/26 shtator 1911, f. 2.

pakurrëfarë rëndësie për kombin shqiptar. Bile, ndërrimin e qeverive dhe të kabineteve në Stamboll, e quante lojë të xhonturqve pa kurrëfarë, rëndësie për popujt joturq: „*Uku kimen e ndron po tabiatin kur!*”<sup>104</sup> Fjala vjen, ngjarjet me rastin e rënies së kabinetit të Seid Pashës dhe formimin e kabinetit të Halit Zija Pashës, në fund të vitit 1911, e quajti me ironi: „*Eski tas eski hamam Izet cidî Halit celdî*” — Çapçak i vjetër banjë e vjetër Izeti ka shkuar Haliti ka ardhur!<sup>105</sup>

Në fillim të vitit 1912 qeveria turke, e shtrënguar nga lëvizja kombëtare shqiptare, shpalli zgjedhjet parlamentare. Këto zgjedhje u inskenuan me qëllim që përmes të zgjedhjes së deputetëve joshqiptarë dhe turkomanë në viset me shqiptarë, të dezorientonte lëvizjen kombëtare shqiptare, e cila po shkonte drejt pavarësisë së Shqipërisë. *Shkupi*, vigjilent si çdo herë, i kuptoi dinakërit e armikut shekullor dhe i thirri bashkëkombësit e vet të „*zgjohen nga gjumi*” me rastin e zgjedhjeve të ardhshme sepse „*lipset ti njofim ato shqiptar qi kan kallzu me vepra patriotizmin e dashurin e vet për kombin e vet, dhe ato ti zgjedhin pa dyshim për depyte*”. Madje insistonte të mos dallonte të varfërit nga të pasurit, por njësi e matjes të vlerave të tij të jetë dashuria për atdheun — „*atdhetar i vyeshëm*”. „*At’here mos u kaboni e mos haroni me zgjedh tjetër njeri perveç se Shqiptetar me vepra per dashur t’kombit t’on!*”<sup>106</sup>

Ngjarjet rreth zgjedhjeve gjatë muajve të parë të vitit 1912 thelluan edhe më hullinë midis turqve osmanllinj dhe popullit shqiptar. Partia politike xhonturke *Xhemiet* dhe komiteti i saj *Ittihad ve Tereki* u bashkuan me të gjithë armiqtë e lëvizjes shqiptare, që të zgjidhnin deputet joshqiptarë si përfaqësues të popullit shqiptar në Parlament. Xhemieti bëri përpjekje edhe për të blerë me para patriotët më në zë dhe partizanët e parë të politikës kombëtare shtetërore në mënyrë që ata të hiqnin dorë nga kandidimi për deputet. Madje *Agjencia Telegrafike e Budapestës në Selanik* njoftonte se Qeveria e Xhemietit i ka ofruar Hasan Prishtinës dy mijë lira „*vetëm të mos bahet deputet*”.<sup>107</sup> Kështu vepruan edhe me Ismal Qemalin e të tjerë, por këta, përfaqësuesit që i përcaktonte populli, mbetën të pathyeshëm, deri në fund të jetës së tyre të papërkulur. Përpjekjen e shqiptarëve në Kosovë e gjetkë, e përkrahte edhe shtypi kombëtar dhe i huaji demokratik jashtë Perandorisë, gjë që plotësonte programin politik të *Shkupit*, i cili i botonte ata artikuj. Gazeta *La Nazione Albanese* i thërriste shqiptarët të mos binin në marrëveshje me partitë politike — Xhemiet dhe *Ittilaf*, sepse „*sa t’vin n’qeverim do jem me beter se kto sot*”,<sup>108</sup> ndërsa gazeta *Indepedant* shkruante se në Pejë do të zgjidhej deputet (mebus) një Popoviq edhe pse deri atëherë në Pejë janë zgjedhur për deputetë nga dy shqiptarë.<sup>109</sup> Gazeta *Adeverul* e Bukureshtit për politikën e qeverisë turke

<sup>104</sup> Nr. 18/8 shkurt 1912 f. 1.

<sup>105</sup> Nr. 12/8 dhjetor 1911, f. 2.

<sup>106</sup> Nr. 16/17 janar 1912, f. 2.

<sup>107</sup> Nr. 19/20 shkurt 1912, f. 2.

<sup>108</sup> Nr. 20/1 mars 1912, f. 2.

<sup>109</sup> Nr. 18/8 shkurt 1912, f. 2.

lidhur me zgjedhjen e deputetëve shkruante: *Dhe n'Kosovë, Xhemiet'i o bashku me serbit kontra Shqiptarëve!*<sup>110</sup>

Kështu, *Shkupi*, duke i ribotuar artikujt e shtypit të jashtëm dhe të huaj lidhur me zgjedhjet parlamentare në viset me shqiptarë, i kontribuoi kultivimit të mendimit politik mbi konceptcionet për përfaqësinë e popullit dhe u bë zëdhënës i luftës kombëtare shqiptare në të gjitha situatat politike, në çdo kohë. „*Ne duem lumnin, përparimin e kombit ton, ne do mundohemi tui sherbum atdheut me ato fuqia qi do kemi, dhe gjith njo do kritikojm ton ato qi bajn zullum e pa drejtsi karshi kombit ton — pa kushdo me konaju*“.<sup>111</sup>

*Shkupi* me tërë guxim e vet u ngrit kundër zgjedhjes së deputetve serbë për përfaqësues të *Shkupit* edhe të rrethinës, sepse ato zgjedhje ishin të inskenuara nga qeveria e Beogradit. Vinte në spikamë se ato zgjedhje kanë dy qëllime: a) për të treguar se në Shkup, në kryeqendrën e Vilajetit më kryengritës të shqiptarëve, ka serbë dhe b) për të treguar, para Evropës, se Shkupi gjendet në „Stara Serbia“. I thëriste bashkëkohësit të protestojnë dhe të mos pranojnë këtë zgjedhje: „*Hapni syt e dini çka punoni, se me nj'at mebus Serb qi do qitni, do vie dita tu qesin syt, e mos degjoni disa sheret — budalla' qi flasin ndryshe, se me 'asnaj do boheni pishmon ju vet!*“ Sugjeronte që personat e kandiduar për deputet të mos i vlerësojnë sipas asaj se sa e çka premtojnë, por me atë se sa e çka kanë bërë për kombin dhe atdheun „*se tani Ty t'lidhet fati për mir e për ligisht e masnaj mos bonesh pishmon e ti biesh kokës pa dermen!*“<sup>112</sup>

Në saje të përpjekjeve maksimale të patriotëve dhe të shtypit kombëtar, në këto zgjedhje, populli u tregua i pathyeshëm kundër intrigave „*si me fjal ashtu dhe me para*“. Shembëll tipik i kësaj rrezistence dhe pathyeshmërie ishte qëndrimi i beratësëve lidhur me zgjedhjen e I. Qemalit. Bile, në telegram dërguar atij, thonin: „*Po, kiamet t'bohet dhe ne asnjë t'mos jesim fajde su bojn, as intrigat as parat; se ne, në rojtmën t'on po t'garantojmë, ja ti mebus i jon do bonesh, ja Vjosa e Shkumini do e ndrojn fytyren e vet natural q'e ka!*“<sup>113</sup> Lidhur me zgjedhje, dibranët shkuan edhe më larg. Patrioti Mersim Dema kishte tubuar rreth *dy mijë burra* dhe kërkonte nga qeveria që për deputet të zgjidhej Basri Beu „*dhe t'hapni mektebe shqipe se ndryshe Drini vjetër mer mnyrë tjetër!*“<sup>114</sup> *Shkupi* u ngrit kundër shqiptarëve të pakuptueshëm, të cilët para intrigave të huaja, harronin qëllimin e armiqve dhe shkaktonin turbullira e përçarje „*pse ska dal depute filani a filan oxhakzade!*“<sup>115</sup> U ngrit kundër oxhaksisë dhe të pasurve, të cilët kishin dalë në krye të masave popullore, duke u mbështetur në pasuri, në mallë, dhe u përpoq vetëm për ata persona që përpiqeshin vetëm për „*t'ardhmen e Shqipënis e kombit ton!*“<sup>116</sup>

<sup>110</sup> Nr. 16/17 janar 1911, f. 2.

<sup>111</sup> Nr. 20/1 mars 1912, f. 2.

<sup>112</sup> Aty. Art. „*Detyra e mebusve faqe kombit*“

<sup>113</sup> Aty. Art. „*Shqipëria e poshtme dhe Ismail Kemali*“

<sup>114</sup> Nr. 23/1 prill 1912, f. 1.

<sup>115</sup> Nr. 25/23 prill 1912, f. 2. Art. „*Shqipëtarët pa gjukim*“

<sup>116</sup> Aty.

Fushata rreth zgjedhjeve parlamentare zgjati deri në muajin qershor 1912. Në Kosovë, në saje të patriotëve kosovarë dhe të organit të parë demokratik *Shkupi*, zgjedhjet përfunduan pa rezultate për qeverinë dhe armiqtë në prapaskenë. Ngadhnjeu populli liridashës. Në Pejë, Gjakovë, Prishtinë, Gjilan, Preshevë, Mitrovicë, Vuçitërnë, Ferizaj dhe Gusi „n'kto vende” populli bojkotoi zgjedhjet sepse ato nuk ishin të lira. Për mosesukses në zgjedhje, për moszgjedhjen e deputetëve, *Shkupi* i fajësonte administratorët në Vilajet dhe me ironi qëllonte: „Egersinave as kush sun u del para. Hum, Hum! ja po vin qentë!” dmth. spiunët e propagandave të huaja në dëm të lëvizjes kombëtare shqiptare.<sup>117</sup>

*Shkupi* i kontribuoi edhe informimit të drejtë lidhur me dezinformimet e sjella në shtypin e jashtëm përkitazi me personat përfaqësues të popullit dhe kombit. Posaçërisht dhe me rrespekt më të lartë e mori nën mbrojtje Hasan Prishtinën. Gazeta *Liri e Shqipërisë* në Sofje, e mbështetur në shkrimet e gazetave austriake, „po shkruen disa sende si me i pa n'ander” kinse „gjoja Is Boletini dhe Riza begu dashkan autonomi e Shqipnis, e Hasan begu s'e paska dasht!!!”. Theksonte se „L. e Sh.” „nuk e din se t'mos ishte Hasan beu dhe Bajram bej Curri me disa shokë tjerë s'bonesht kurgjo as per gjuhë as për Shqipni”. I sugjeronte „L. Sh.” të mos shkruante më për „ato sende qi si die e s'ja pret mendja” por me shkrimet e veta të ngrisë frymën luftarake të popullit shqiptar, sepse qeveria e Turqisë nuk do të plotësojë „ato 14 bendet q'i kemi kerku”, të formuluar nga H. Prishtina dhe „t'i thot e kshillu Hasan begun e shokve ti” të përgatiten se u duhet prapë me marrë pushkën në dorë „e me luftue për ato të drejtat e kombit ton, e jo per kolltukat e buta mi gjersin e gjakut e luftarit shqiptar.”<sup>118</sup>

Ky organ e vlerësoi lartë vlerën dhe rolin e Hasan Prishtinës, si përfaqësues i vërtetë i popullit dhe luftëtar i paepur për lirinë kombëtare. Në pranverë të vitit 1912, komiteti *Ittihad ve Tereki* i parashtrroi kërkesën parlamentit që të anulohet nenin e 35 të Ligjit Themeltar (Kanuni Sasi), i cili garantonte liritë kombëtare për të gjitha nacionalitetet në Perandori. Hasan Prishtina, si përfaqësues i popullit të këtyre anëve në Parlament, në seancë kur diskutohej për eliminimin e këtij neni, me guxim të madh, u ngrit kundër: „Po n'qoft qi do ngjajë kjo pun, t'a dini se n't'gjith anët do shpallet revolucia dhe un do jom një flamur mbajtes (bajraktar) i ksaj. Dhe fuqia e ushtris do jetë e pa fuqishme faqe eqqarit kombit!” Hasan Prishtina, shkruante *Shkupi* iu kërcënua haptas xhonturqve se „pa çare duhet t'a din mir, se Mretnia Otomane s'o gjo tjetër, përveç një shoqni e fillueme me dashur t'shumëve kombe qi dun t'rrojn bashk mas interesit vet”.<sup>119</sup> Duke botuar deklaratën e H. Prishtinës SHKUPI edhe më tutje e lapidarësoi mendimin politik dhe shoqëror mbi përfaqësinë e popullit.

<sup>117</sup> Nr. 29/16 qershor 1912, f. 1.

<sup>118</sup> Nr. 32/30 gusht 1912, f. 2.

<sup>119</sup> Nr. 27/15 maj 1912, f. 2.

#### 14. Idetë mbi autonominë dhe pavarësinë e Shqipërisë

Kultivimi i dashurisë ndaj atdheut ishte ide programatike e udhëheqëse e veprimtarisë publicistike të bashkëpunëtorëve të *Shkupit*. Në faqet e saj u mbollën dhe u kultivuan me sukses idetë dhe konceptcionet mbi autonominë dhe pavarësinë. Patriotët e kohës së *Rilindjes*, të mësuar nga historia, duke filluar edhe para Lidhjes së Prizrenit, aktin e autonomisë së Shqipërisë e konsideronin si shkallë të parë drejt pavarësisë. Ishin të bindur se me fitimin e autonomisë, atdheu për disa vjet do të përparonte në fushën e kulturës dhe të ekonomisë dhe të forcimit ushtarak, saqë, do të bëhej e zonja t'i përballojë çdo agresori të jashtëm dhe reaksionit të brendshëm. Kështu do të sigurohej më lehtë integriteti i vendeve të banuara me shqiptarë. Këso konceptcionesh politike kultivoi edhe gazeta „*Shkupi*“, por varësisht nga koha kur doli, kjo gazetë shkoi edhe më larg — drejt shkëputjes nga Turqia, akt ky që do të realizohej me luftë për lirinë kombëtare e shtetërore.

Në luftën për autonomi ideja e bashkimit kombëtar qëndronte mbi të gjitha, madje dhe mbi besimin dhe ndiesitë e brendshme të shqiptarëve. Duke botuar edhe komentuar programet politike dhe dokumente të tjera të lëvizjes kombëtare në emigrim, gazeta kosovare u bë tryezë e përbashkët, ku u bë integrimi i ideve autonomiste të kultivuara në atdhe dhe në kolonitë shqiptare jashtë Shqipërisë, duke rrumbullakësuar, kështu, mendimin e tërësishëm politik e shoqëror kombëtar mbi autonominë dhe pavarësinë e Shqipërisë. Në këtë kohë shqiptarët e Malësisë së Mbishkodrës gëzonin njëfarë autonomie të fituar që nga Kongresi i Berlinit. Kjo „autonomi“ u realizua me përpjekjen e Austrisë, e cila duke shfrytëzuar ndjenjat fetare mendonte të bënte Malësinë bazë për ekspansion në Ballkanin Jugor drejt Selanikut. Patriotët nga krahinat e tjera me shqiptarë u përpoqën që këtë autonomi, pa austriakë, ta zgjeronin mbi të gjitha viset me shqiptarë. Këso konceptcionesh kultivoi edhe *Shkupi*.<sup>120</sup> Në trajtesat e botuara në faqet e saj shtroi rrugën dhe dimenzionet e autonomisë. *Shkupi* ishte për një autonomi të vendeve me shqiptarë në Vilajetin e Kosovës, Shkodrës, Manastirit dhe të Janinës, pa kurrfarë pretendimesh territoriale në vendet e banuara me popullsi tjetër. Kërkonte autonominë e Atdheut, të vendit të „*dashtun (...)* ku kemi lee e ku gjinden eshtnat e t'parvet t'onë, qi kanë lanë një zaa e nj'emen qi kurr s'ju harrohet per trimnii e burrii“.<sup>121</sup>

*Shkupi* me kujdes e përcolli tërë lëvizjen për autonomi në suazat krahinore shqiptare dhe u përpoq për shmangien e separatizimit krahinor autonomist. Shkruante për kërkesën e mërgatës shqiptare të Rumanisë te qeveria turke për dhënien e autonomisë vendeve me shqiptarë dhe njëkohësisht theksonte se atë telegram e kanë nënshkruar njëmijë e dyqind

<sup>120</sup> Nr. 2/5 shtator 1911. f. 2. Art. „Telegram Vezirit në Stamboll“

<sup>121</sup> Nr. 10/5 nëntor 1911. f. 1.

vetë „gegë e toskë, muslimanë, katolikë e ortodoksë të bashkuar si vëllazën prej një gjaku e një gjuhe”.<sup>122</sup> Kërkesë për autonomi krahinore kishin shtruar edhe krerët nga Vilajeti i Janinës dhe të gjysmës së Vilajetit të Manastirit, me një fjalë — Toskëria. Ata kërkonin nga qeveria liri kombëtare dhe autonomi: „Dhe ne dum t’na grofje aju Djell qi ka grof dhe tjerët milete si dhe një pjes nga vllaznit t’on (...) Malcis Shkodres”.<sup>123</sup> Kërkesë për autonomi krahinore kishin shtruar edhe Peja me rrethinë. Madje Mahmut Zajmi, Valiut të Kosovës i dërgoi notë të shkruar shqip me pesë pika tui lyp drejtësi si t’Malsis Shkodres”.<sup>124</sup> Kërkesa për autonomi shtruan edhe shqiptarët e Malësisë së Madhe, Dibrës së Poshtme dhe të Bulçizës. *Shkupi* e njoftonte opinionin se populli i atyre tri krahinave ishte tubuar në shtatë teqe dhe kishin lidhur besën e fundit për t’ia thënë „fjalën e fundit Mbretnis”: „Me na dhan Mretnia t’on dhe nave ato t’drejta qi va dhe Arabve t’Jemenit dhe Vllaznive t’on Malisor t’Shkodres”.<sup>125</sup>

Këto kërkesa lokale *Shkupi* nuk i pëlqente dhe, në prag të luftës ballkanike e ngriti edhe më lartë kërkesën për autonomi në suaza të vendeve me shqiptarë dhe synoi nga pavarësia e plotë e atdheut. Me arsye u drejtohej bashkëkohësve: „Tesh po kini dishir e t’mos jemi mallku pej atyneve qi do vin mas ne; dhe t’turproheni prej atyneve qi na e lan ket emën e nder e cila quhet Shqipni pa lodhën t’punojm për dritën e emnit t’Shqipnis!”.<sup>126</sup>

Në gjysmën e dytë të vitit 1912 lëvizja kombëtare në Kosovë e gjetkë mori përpjesëtime më të diferencuara drejt pavarësisë, në një anë, ndërsa në anën tjetër, rreziku nga jashtë u shtua edhe më shumë. Edhe reaksioni i brendshëm xhonturk sa vinte e shtoej. Megjithatë, midis dy rreziqeve — *Sciles* dhe *Haribdit*, gazeta revolucionare e Kosovës, me vendosmëri i bëri opinionit me dije se e vetmja dëshirë e shqiptarëve ishte „një Shqipni të lir të qytetnume e të përparume!” dhe thërriste atdhetarët në Vilajetin e Janinës, Manastirit, të Shkodrës dhe të Kosovës: „Hapni syt e kapnu për punë e sherbu per idealin ton të bukur për Atdhe!”<sup>127</sup>

*Shkupi* shpëtimin e atdheut, nga shumë rreziqe që vinte në pah, e mbështeti vetëm në forca të bashkuara të atdhetarëve shqiptarë. Vinte në spikamë se „T’on e dun Shqipnin, po e dun m’e coptu a m’e mar njoni per vetje; po sido qi sun e mer asnjoni ashtu lehtë, per vete, po e lon ashtu si noj qen kur do me gordhë vet unit”. Erdhi në përfundim se shtetet e interesuara nuk do të heqin dorë nga plani për copëtimin e viseve të banuara me shqiptarë, por ndarja do të zbatohet vetëm në momentin kur këto shtete do të pajtoheshin mbi ndarjen e gjahut. Ajo i thirri bashkëkohësit të përgatiteshin për luftë kundër agresorit të paevitueshëm, pa u mbështetur

<sup>122</sup> Nr. 2/5 shtator 1911, f. 2.

<sup>123</sup> Nr. 17/27 janar 1912, f. 1. Art. „Letër prej Gjirokastrë (Ergjeri)”

<sup>124</sup> Nr. 25/23 prill 1912, f. 1. Marrë nga gazeta „Obzor” e Zagrebit. Art. „Mahmut Zajmi dhe Hyqymeti”

<sup>125</sup> Nr. 29/16 qershor 1912, f. 1.

<sup>126</sup> Nr. 30/ 3 korrik 1912, f. 1.

<sup>127</sup> Nr. 32/30 gusht 1912, f. 2.

në ushtrinë perandorake. Bile ajo konstatonte: „Pej zh. Turqve mos pritni kurgjo, se ajo so kon e zoja me nreq veten qe shtat qint vjet, e jo tani do na nreqë neve” dhe se fati i shtetit të lirë shqiptar është në duart e shqiptarëve.<sup>128</sup>

### Përfundimi

Tërë ajo që kemi sjellë këtu, për mendimin politik e shoqëror në gazetën *Shkupi* pasqyron mirë rëndësinë historike kombëtare dhe demokratike të këtij organi të Rilindjes Kombëtare Shqiptare në Kosovë. Nuk është e tepër të vëmë në spikamë se mendimin politik dhe shoqëror në këtë gazetë e klasifikuam dhe e përpunuam duke vështruar gazetën, përkatësisht mendimin e kultivuar në të, nga dy drejtime: në thellësinë vertikale, sipas natyrës së problematikës dhe, në shtrirjen horizontale, sipas kronologjisë së ngjarjeve të trajtuara.

Mendimi politik e shoqëror i kultivuar në këtë gazetë luajti rol të rëndësishëm në rritjen e ndërgjegjës kombëtare të masave popullore dhe në prezentimin e aspiratave kombëtare shqiptare para botës. Veçmas e ndihmoi luftën për shkollën kombëtare dhe emancipim. Konceptonet politike dhe porosia shoqërore në *Shkupin* kanë qenë të qarta, origjinale dhe me ndikim permanent ndër lexuesit. Me sukses luftoi kundër armiqve të gjuhës dhe shkollës shqipe, traditat e mbrapshta, ndasinë fetare dhe krahinore dhe kultivoi dashurinë ndaj popullit dhe lirisë. Idetë demokratike dhe socialiste punëtore të kultivuara në faqet e *Shkupit*, lëvizjes kombëtare shqiptare për liri dhe pavarësi i dhanë vulën e lëvizjes revolucionare demokratike.

*Shkupi* shpëtimin kombëtar shqiptar dhe të kombeve të tjera nuk e shihte në fuqinë dhe vullnetin e princave, mbretërve, kabineteve politike borgjeze, e, as nga borgjezia dhe parësia. E kultivoi dashurinë ndaj masave, ndaj shtresave të gjera popullore. Në këto e shihte armatën e lirisë, të atdheut dhe të njerëzimit. Konceptonet lidhur me përfaqësinë e popullit, lëvizjen e armatosur popullore kombëtare, për autonomi dhe pavarësi të atdheut, janë të nivelit të lartë të mendimit politik e shoqëror revolucionar e vizionar. Kur të kihen parasysh rrethanat në të cilat doli *Shkupi* konceptonet lidhur me problemin e shtruar në këtë studim, janë ndër më të qartat dhe më të plotat se konceptonet e mendimit politik e shoqëror të kultivuara në organet e tjera kombëtare të kohës që dilnin në qendrat e tjera të atdheut ose jashtë Perandorisë, në rrethana shumë më të mira dhe më të volitshme politike dhe financiare.

Jam i vetëdijshëm se në këtë studim nuk ia kam dalë të vjel në tërësi *Shkupin*, sado që kam shkuar në gjerësi dhe thellësi të problematikës, sepse gazeta paraqet interes për shumë shkenca shoqërore dhe disiplina e

<sup>128</sup> Nr. 33/19 shtator 1912, f. 2. Art. „Kush e don Shqipnin”

kategori të mendimit politik e shoqëror, filozofik, artistik, publicistik, lingvistik, leksikologjik e të tjera. Është me interes të posaçëm për historinë e të folmeve shqipe të dialektit dhe të nëndialekteve të Veriut, për morfologjinë dhe sintaksën e saj. Gjuha e *Shkupit* është e kuptueshme, e thjeshtë dhe e pasur me krahinarizma dhe neologjizma.<sup>129</sup>

Muhamet Pirraku

LE JOURNAL PERIODIQUE „SHKUPI”  
(QUELQUES CATEGORIES DE LA PENSEE POLITIQUE ET SOCIALE)

R é s u m é

Le périodique „Shkupi” est le premier organ en albanais dans les pays du vilayet de Kosova. Il apparût au centre du vilayet, à Shkup, le 29 août 1911 comme périodique hebdomadaire en devises: „Prun’interest’e kombit”. Les guerres balkaniques ont interrompu sa parution.

La problématique traitée dans ses pages est bariolée et elle présente un trésor précieux de la matière pour des recherches historiques et linguistiques. Le périodique avait des collaborateurs de tout les pays habités par des albanais. Cela émane du style et de la langue des écritures.

Dépendant de la problématique avec laquelle „Shkupi” est confronté, les catégories de la pensée politique et sociale, cultivées dans ses pages peuvent être systématisées en: esprits politiques et sociaux du ligne programatique, idées éducatives, idées sur la nationalité, idées démocratiques, esprit politique et social des traitements linguistiques, culture de l’histoire, lutte contre la propagande étrangère au préjudice des albanais, attitude politique envers le gouvernement turc et des partis politiques en Turquie, puis envers la vengeance, insurrections albanaises; vision et attitude envers la politique expansioniste des bourgeoisies des voisins dans les pays de l’empire, vision envers la politique colonialiste des grandes puissances dans les pays de cet empire, conceptions sur la représentation du peuple, idées sur l’autochtonie et de l’indépendance nationale et de l’esprit de la pensée politique et sociale de la poésie publiée dans „Shkupi”.

La langue du périodique „Shkupi” est compréhensible, simple populaire, riche en termes des provinces et en néologismes formés sur la langue du peuple, c’est pourquoi elle est d’un intérêt particulier pour l’histoire des parlers albanais du dialecte et des sous-dialectes du Nord pour la morphologie et pour la syntaxe.

<sup>129</sup> Këtu nuk i botojmë pjesët e këtij punimi: „Fryma politike e shoqërore e trajtesave gjuhësore dhe „Fryma politike e shoqërore e pazisë të botuar në „SHKUPI”. E fundit është botuar në *Bota e re*, Prishtinë 1975.

Në temë mbi „SHKUPIN” deri tani nuk është shkruar komplet. *Shkupin*, disa artikuj të tij, si burim për studimin e vet e ka shfrytëzuar Dr J a s h a r R e x h e p a g i q: *Zhvillimi i arsimit dhe sistemit shkollor të kombësisë shqiptare në territorin e Jugosllavisë së shtetë deri në vitin 1918*, Prishtinë 1970.; M. P i r r a k u, për punimin, *Legalizimi i alfabetit të Manastirit, Përparimi* 11-12/1968; *Idetë arsimore në gazetën (kosovare) „Shkupi”, Shkëndija* Nr. 2,4,5/1973 dhe artikulli: *Gazeta „Shkupi” mbi vrasjet*, *Rilindja* 13 VII 1969.